



# KURTI I INFORMON LIDERËT E SHQIPËRISË PËR MARRËVESHJEN E OHRIT



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar të dielën një vizitë në Tiranë. Ai është takuar me autoritetet më të larta të Shqipërisë. Në qendër të

bisedimeve ishte marrëveshja e arritur në Ohër më 18 mars në mes të Kosovës dhe Serbisë për zbatimin e planit evropian, e cila është përshëndetur nga autoritetet

më të larta të Shqipërisë, por edhe bashkëpunimi mes dy vendeve në politikë, në proceset integruuese, ekonomike, arsimore, kulturore dhe sportive

## PËRKUJTOHET MASAKRA NË KRUSHË TË MADHE: SERBIA KREU GJENOCID MBI POPULLATËN SHQIPTARE, AJO DUHET TË DËNOHET

FAQE 5



HAXHIU VIZITON ISH-UDHËHEQËSIT E UÇK-SË NË HAGË: ATA JANË TË PATHYESHËM, DREJTËSIA DO TË TRIUMFOJË

FAQE 6

SHBA-ja: NUK KA INDIKACIONE SE RUSIA PO PLANIFIKON TË PËRDORË ARMË BËRTHAMORE

F.2


24 VJET MË PARË FORCAT SERBE VRANË DHE MASAKRUAN 50 ANËTARË TË FAMILJES BERISHA NË SUHAREKË

F.3

KURTI TAKON DREJTUESIT E QENDRAVE TË LV-SË NË KOSOVË DHE MËRGTATË, TEMË DISKUTIMI QEVERISJA DIVJEÇARE

F.6

## EKONOMI



"SHTRENJTIMI I RRYMËS PO NA VARFËRON"

F.7

HOTI: 2.5 MILIARDË EURO KURSIME TË TRUSTIT NË MËSHIRË TË TREGUT

F.7

## KULTURË



ARTEFAKTE NGA KOSOVA DO TË PARAQITEN NË SHBA

F.6

**RENOVA**  
PUTZ

Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289

E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE

INFO: 049-111-101,  
044-511-177

[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**

[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency

Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...

## Tunizi: Të paktën 29 migrantë vdesin pas fundosjes së dy anijeve

**TUNIZ, 26 MARS** - Të paktën 29 migrantë kanë vdekur pasi dy anije të vogla u fundosën afër brigjeve të Tunizisë brenda disa orësh nga njëra-tjetra, thanë zyrtarët. Migrantët nën-saharianë po tentonin ta kalonin Mesdheun për të arritur në Itali. Fundosja e dy anijeve është në serinë e ngjarjeve të ngjashme që kanë ndodhur në brigjet tuniziane në ditët e fundit, pasi në katër ditët e fundit janë fundosur edhe pesë anije të tjera. Këto ngjarje vijnë pasi Tunizia ka nisur një fushatë kundër migrantëve afrikanë pa

dokumente. Ndërkaq, zyrtarët italianë në ishullin e Lampedusës kanë thënë se janë të mbingarkuar, pasi kanë regjistruar rekord të arritjes së migrantëve brenda 24 orëve, përkatësisht 2 500 migrantë. Kryeministrja e ekstremit të djathtë në Itali, Giorgia Meloni, ka paralajmëruar se Evropa mund të përballet me rreziqe pasi një valë e madhe refugjatësh mund të arrijë në kontinent. Tunizia është bërë qendër për migrantët të cilët duan të arrijnë në Evropë. Kombet e

Bashkuara kanë thënë se të paktën 12 000 migrantë që kanë arritur këtë vit në brigjet italiane ishin nisur nga Tunizia. Kjo shifër ishte 1 300 në periudhën e njëjtë në vitin e kaluar. Megjithatë, rojet bregdetare tuniziane kanë thënë se po ndërmarrin hapa për t'i ndaluar migrantët që të kalojnë Mesdheun, duke argumentuar se kanë ndaluar rreth 80 anije që ishin nisur drejt Evropës në katër ditët e fundit. Autoritetet tuniziane po ashtu kanë thënë se kanë arrestuar mbi 3 000 migrantë.



## ShBA-ja: Nuk ka indikacione se Rusia po planifikon të përdorë armë bërthamore



**WASHINGTON, 26 MARS** - Departamenti amerikan i Mbrojtjes tha se nuk ka indikacione se Rusia po përgatitet të përdorë armë bërthamore pasi Moskë njoftoi se do të dislokojë armë bërthamore taktike në Bjellorusi. "Kemi parë raportime për njoftimin e Ruisë dhe do të vazhdojmë ta monitorojmë këtë situatë", tha Departamenti amerikan i Mbrojtjes përmes një deklarate.

"Ne nuk kemi parë asnjë arsye për ta ndryshuar qëndrimin tonë strategjik bërthamor apo ndonjë indikacion se Rusia po përgatitet të përdorë armë bërthamore. Ne vazhdojmë të jemi të përkushtuar në mbrojtjen kolektive të aleancës së NATO-s", tha ShBA-ja. Më 25 mars presidenti rus Vladimir Putin njoftoi se ka arritur marrëveshje për të vendosur armë bërthamore taktike në territorin e aleates së

ngushtë, Bjellorusisë, e cila kufizohet edhe me Rusinë, edhe me Ukrainën. Zyrtarët ukrainas kanë thënë se me këtë marrëveshje Bjellorusia është bërë "peng bërthamor" i Moskës. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022, duke përdorur territorin bjellorus për të dërguar trupa në Ukrainë. Bjellorusia, aleatja e Ruisë, mohon se është palë në konflikt.

## Putini: Rusia dhe Kina nuk po krijojnë aleancë ushtarake

**MOSKË, 26 MARS** - Rusia dhe Kina nuk po krijojnë një aleancë ushtarake dhe nuk po fshehin asgjë, në kuptim të bashkëpunimit ushtarak, tha presidenti rus Vladimir Putin, në një intervistë të transmetuar të dielën nga televizioni shtetëror rus. Putini dhe presidenti i Kinës, Xi Jinping, thanë se shtetet e tyre kanë miqësi dhe u zotuan për lidhje më të ngushta gjatë takimit të tyre në Moskë në fillim të kësaj jave, në kohën kur Rusia po përpiqet të shënojë fitore në atë që e quan "operacion të posaçëm ushtarak" në Ukrainë.

"Ne nuk po krijojmë ndonjë aleancë ushtarake me Kinën", citohet të ketë thënë Putini, sipas "Interfax". "Po, ne kemi bashkëpunim në sferën e ndërveprimit ushtarako-teknik. Ne nuk e fshehim këtë. Gjithçka është transparente, nuk ka asnjë sekret", shtoi lideri rus. Putini, po ashtu, tha se fuqitë perëndimore po tentojnë të krijojnë më shumë aleanca globale, duke akuzuar Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n se kanë nisur të ndërtojnë një "bosht" të ri që, sipas tij, ka disa ngjashmëri me aleancën e Gjermanisë, Italisë dhe Japonisë në Luftën e



Dytë Botërore. "Prandaj analistët perëndimorë... po flasin lidhur

me atë se Perëndimi po nis të ndërtojë një bosht të ri të

ngjashëm me atë që u krijua në vitet '30 nga regjimet fashiste të Gjermanisë, Italisë dhe regjimi ushtarak i Japonisë", tha Putini. Me urdhër të Putinit, forcat ruse nisën pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt 2022. ShBA-ja së fundmi ka paralajmëruar se Kina mund t'i ofrojë armë Ruisë, gjë që është mohuar nga Pekini. Kina nuk e ka dënuar pushtimin rus të Ukrainës, por së fundmi ka nxjerrë një plan me 12 pika për luftën në Ukrainë, duke argumentuar se dëshiron që konflikti të zgjidhet përmes dialogut.

## Shkatërrime në Misisipi pas tornados vdekjeprurëse

**MISISIPI, 26 MARS** - Të paktën 26 persona kanë vdekur në Misisipi dhe Alabama pasi një tornado goditi shtetet në jug të Shteteve të Bashkuara. Përpjekjet për kërkim-shpëtim po vazhdojnë dhe autoritetet në Misisipi kanë

shpallur gjendje emergjente. Në Rolling Fork, vetura të shkatërruara, tulla shtëpish dhe gjësende të tjera janë parë në rrugë, teksa ky qytet është shkatërruar pothuajse i tëri. Në qarkun Sharki shtëpitë janë shkatërruar nga tornadoja.

Tornadoja goditi në mes të natës, në kohën kur banorët po flinin dhe nuk kishin dëgjuar alarmet paralajmëruese. Për shumë banorë, treguesi i parë se diçka nuk ishte në rregull ishte zhurma e madhe.



# Përkujtohet masakra në Krushë të Madhe: Serbia kreu gjenocid mbi popullatën shqiptare, ajo duhet të dënohet

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, tha se më 26 mars 1999 në Krushë të Madhe ndodhi masakra që do ta trondiste botën e civilizuar. “Egërsirat serbe vranë e masakruan 241 fëmijë, gra, pleq e burra të paarmatosur. Ky është gjenocid mbi popullatën shqiptare, për të cilin shteti serb duhet të dënohet sipas ligjeve ndërkombëtare”, ka thënë kryetari Latifi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 MARS - Më 26 mars 1999 në Krushë të Madhe forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe vranë e masakruan 241 fëmijë, gra, pleq e burra të paarmatosur. Edhe pas 24 vjetësh nga kjo masakër, 64 shqiptarë të Krushës mbeten ende të zhdukur dhe nuk dihet asgjë për fatin e tyre. Në të njëjtën ditë u vranë e u masakruan edhe 113 fëmijë, të rinj, burra dhe gra në fshatin Krushë e Vogël, ku 60 prej tyre edhe pas 24 vjetësh ende nuk dihet ku janë e vazhdojnë t'i kenë varret e zbrazëta. “Më 26 mars 1999 në Krushë të Madhe ndodhi masakra që do ta trondiste botën e civilizuar. Egërsirat serbe vranë e masakruan 241 fëmijë, gra, pleq e burra të paarmatosur. Ky është gjenocid mbi popullatën shqiptare, për të cilin shteti serb duhet të dënohet sipas ligjeve ndërkombëtare. Serbia duhet të pendohet dhe të kërkojë falje për krimet e lahtarshme, por edhe duhet që drejtësia të prevalojë për ta fashitur dhimbjen e familjeve dhe kombit tonë”, u shpreh kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.

Ndërkaq presidentja dhe kryeministri i Kosovës janë zotuar se kanë prioritet vendosjen e drejtësisë sa iu përket krimeve të luftës të kryera në Kosovë nga forcat ndaj shqiptarëve, teksa kanë kujtuar të vrarët në Krushë të Madhe 24 vjet më parë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se ende fati i 64 banorëve të Krushës së Madhe mbetet i pazbardhur, të cilët figurojnë në listën e personave e të zhdukurve me dhunë. “Krimet e luftës asnjëherë nuk vjetërsohen, njësojë sikur edhe gjenocidi që kishte për qëllim shfarosjen e popullit shqiptar. Ndaj sot dhe gjithnjë nuk do të ndalemi së kërkuari që autorët të vihen para

drejtësisë dhe që fati i patriotit të madh, Ukshin Hoti dhe të gjithë krushianëve të tjerë të zbardhet”, tha ajo.

Sipas presidentes Osmani, Kosova ka bërë “luftë çlirimtare, ndërkaq Serbia kreu gjenocid mbi popullin tonë”. “Ne duhet të besojmë e të angazhohemi të gjithë së bashku për ta mbrojtur të vërtetën, e cila po tenton të tjetërsohet dhe për ta vendosur drejtësinë”, theksoi ajo. Memorialet në Krushë të Madhe dhe të Vogël i vizitoi edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili tha se fati i të pagjeturve është prioritet për ekzekutivin që ai udhëheq. Megjithatë, ai tha se Serbia po vazhdon t'i “mohojë krimet” e kryera në Kosovë. “Ata nuk janë thjesht të pagjetur, ata janë të zhdukur me dhunë dhe dy janë preokupimet tona kryesore. E para është hapja e arkivave në Beograd meqenëse atje është e vërteta për planet gjenocidale të Serbisë që rezultuan me qindra masakra në Kosovë. E dyta zbulimi i varrezave të reja masive dhe dihet se një gjë e tillë ka hasur në shumë pengesa në Serbi, ku në pesë varreza masive në vitet e shkuara janë zbuluar afër 1 000 trupa të shqiptarëve. Por, natyrisht që ne dyshojmë se ka edhe të tjera, mirëpo asnjëherë nuk ka qenë e lehtë kërkesa dhe hulumtimi për varreza të tjera”, tha Kurti.

Masakra në fshatin Krushë e Madhe është më e madhja që ka ndodhur në Kosovë.

Forcat policore dhe ushtarake serbe në këtë fshat nisën aksionin më 25 mars dhe zgjati deri më 27 të vitit 1999. Në këtë masakër u vranë 241 qytetarë, nga ta shtatë fëmijë, pesë gra (njëra shtatzënë) dhe mbijetuan 25 të plagosur rëndë.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998-99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur.



## 24 vjet më parë forcat serbe vranë dhe masakruan 50 anëtarë të familjes Berisha në Suharekë

Para 24 vjetësh forcat serbe vranë dhe masakruan 50 anëtarë të familjes Berisha në Suharekë. Mes tyre edhe 11 fëmijë. Pas vrasjeve, rrëmbyen edhe kufomat. Zhdukën kufomat, në përpjekje të zhdukjes të së vërtetës. “Por kjo e vërtetë kriminale e shtetit të Serbisë nuk mund të zhduket e as harrohet. Kjo është e kaluara jonë e cila nuk kalon. U përkulemi për forcën e pashembullt të

mbijetuarve të vetëm të kësaj masakre, zonjës Shyhrete, zonjës Vjollca dhe Gramozit. Përkulemi me nderim të përvetshëm para të gjithë atyre që u flijuan. I përvetshëm qoftë kujtimi për ta!”, ka thënë kryeministri Albin Kurti.

Edhe presidentja Vjosa Osmani ka përkujtuar 24-vjetorin e masakrës ndaj familjes Berisha. “24 vjet më parë ndodhi masakra e tmerrshme ndaj një familjeje të

tërë. 46 anëtarë të familjes Berisha u masakruan në pragun e shtëpisë, ndërsa kufomat iu bartën gjetiu. Fati deshi që tre nga ta, Vjollca me të birin dhe Shyhretja të shpëtonin. Sot ata e mbajnë gjallë kujtimin për anëtarët e vrarë dhe kujtesën për gjenocidin ndaj nesh. Ata janë kujtesa e dëshmia e këtij gjenocidi ndaj shqiptarëve të Kosovës”, është theksuar në deklaratën e Osmanit.





KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, KA VIZITUAR TË DIELËN SHQIPËRINË

# Kurti i informon liderët e Shqipërisë për marrëveshjen e Ohrit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar të dielën një vizitë në Tiranë. Ai është takuar me autoritetet më të larta të Shqipërisë. Në qendër të bisedimeve ishte marrëveshja e arritur në Ohër më 18 mars në mes të Kosovës dhe Serbisë për zbatimin e planit evropian, e cila është përshëndetur nga autoritetet më të larta të Shqipërisë, por edhe bashkëpunimi mes dy vendeve në politikë, në proceset integruese, ekonomike, arsimore, kulturore dhe sportive

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**TIRANË, 26 MARS** - Kryeministri Albin Kurti ka vizituar të dielën Shqipërinë. Ai është pritur në takime të veçanta nga zyrtarët më të lartë të këtij shteti, presidenti Bajram Begaj, kryeministri Edi Rama dhe kryetarja e parlamentit Lindita Nikolla.

Në qendër të bisedimeve ishte marrëveshja e arritur në Ohër më 18 mars në mes të Kosovës dhe Serbisë për zbatimin e planit evropian. Gjithashtu, u diskutua edhe për tema të tjera mes dy vendeve. Pas takimit me Kurtin, presidenti Begaj ka thënë se biseduan mbi zhvillimet më të fundit të negociatave në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Vlerësova lart maturinë dhe kurajën e treguar nga kryeministri Kurti dhe ekipi negociator i Republikës së Kosovës për ta

pranuar planin evropian si dhe për ta nënshkruar e zbatuar atë. Theksova se dakordimi publik dhe angazhimi i palëve për ta zbatuar planin evropian të normalizimit të marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë dhe aneksin përkatës, si një pjesë integrale të tij, është një garanci më shumë për paqen, stabilitetin dhe të ardhmen e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian", ka thënë presidenti Begaj.

Duke e falënderuar për mikpritjen dhe bashkëpunimin e afërt, kryeministri Kurti e njoftoi presidentin Begaj për qeverisjen dyvjeçare dhe progresin e Kosovës, me theks në sundim të ligjit, luftim të korrupsionit dhe avancim demokratik të vendit. Gjithashtu, Kurti tha se diskutuan për takimin e lartë politik në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të datës 18 mars në Ohër. Me këtë

rast, kryeministri Kurti e njoftoi presidentin Begaj për marrëveshjen e arritur, elementet e saj dhe për qasjen e

konstruktive që Kosova ka ndjekur në këtë takim, por edhe gjatë gjithë procesit. "Shpreha besimin se zotimi i marrë nga palët në Ohër do të respektohet plotësisht, ndërkohë do të gjenden mekanizmat e duhur për ta kthyer këtë dakordim publik në një marrëveshje të detyrueshme e të zbatueshme për palët ndërkombëtarisht", ka thënë Kurti.

Edi Rama në "Facebook" ka treguar se ka pasur një takim me mikun e posaçëm, kryeministrin

e Kosovës, Albin Kurti. "Gjatë drekës së sotme diskutuam me detaje për marrëveshjen e Ohrit dhe ecurinë e mëtejshme të procesit të zbatimit të saj. I shpreha Albinit të gjithë simpatinë time për kurajën dhe realizmin me të cilin ka hedhur hapa me rëndësi të madhe drejt normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. E inkurajova kryeministrin për hedhjen e hapave të mëtejshëm qoftë për garantimin e komunave serbe në kornizën e asociacionit që



# PSD-ja protestoi kundër themelimit të Asociacionit

PRISHTINË, 26 MARS - Partia Socialdemokrate (PSD) ka protestuar kundër Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që liderët e dy shteteve arritën nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Kreu i kësaj partie, Dardan Molliqaj, tha se kjo marrëveshje paraqet “një faqe të keqe”, teksa akuzoi qeverinë e kryeministrit Albin Kurti se është dorëzuar për ta krijuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe që, sipas tij, do t'i japë autonomi komunitetit serb në Kosovë. “Askush në Kosovë nuk beson se duhet të krijohet entitet politik, paralel e etnik. Andaj, besojmë se duhet t'i vazhdojmë

përpjekjet tona për ta ndaluar Qeverinë, e cila është e qartë se u dorëzua para nevojës për të mbajtur pushtet”, tha Molliqaj në protestën para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës.

Më 27 shkurt në Bruksel Kosova dhe Serbia u pajtuan për marrëveshjen drejt normalizimit të raporteve mes shteteve, apo siç njihet ndryshe edhe si propozimi evropian. Më 18 mars palët u pajtuan në Ohër për aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.


Në tekstin e marrëveshjes, nëni 7 përmend sigurimin e një “niveli të përshtatshëm të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë” që, sipas Molliqajt, nënkupton themelimin e Asociacionit.

Kryeministri Kurti edhe në kohën kur ka qenë në opozitë e ka kundërshtuar themelimin e Asociacionit, që ai e ka quajtur ‘Zajednica’, duke argumentuar se rrezikon që në Kosovë të krijohet një Republika Sërpska sikurse në Bosnjë-Hercegovinë.

Megjithatë, Kurti ka thënë se fjala vetëmenaxhim nuk mund të barazohet me Asociacion. “Tani që ka vendosur ta themelojë Asociacionin, nuk po e quan më as ‘Zajednicë’, as Asociacion, por po pretendon ta quajë vetëmenaxhim. Nuk ka emër që e zëvendëson atë që po i ndodh Kosovës. Ajo që po i ndodh Kosovës është e qartë: është autonomi territoriale, etnike për komunitetin serb në Kosovë. Dhe, po ashtu, zona të veçanta me karakter ekstraterritorial përreth kishave dhe manastireve ortodokse”, tha Molliqaj.

Në protestën e organizuar të shtunën nga PSD-ja, që nuk është parti e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, morën pjesë dhjetëra persona. Protestuesit zëvendësuan flamujt e Kosovës, të vendosur te ndërtesa e qeverisë, me flamuj të bardhë, për ta simbolizuar “dorëzimin” me pranimin e Marrëveshjes së Ohrit. Po ashtu, PDS lëshoi tym të zi drejt ndërtesës së qeverisë, për të treguar, siç tha, “zymtësinë” që ka sjellë qeveria Kurti.

Kosova dhe Serbia, në kuadër të dialogut të Brukselit, kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin, më



2013 dhe 2015. Megjithatë, më 2015 Gjykata Kushtetuese tha se marrëveshja duhet të harmonizohet, pasi disa pika të saj nuk janë në harmoni me aktin më të lartë juridik të shtetit.

Kosova dhe Serbia më 18 mars, në Ohër të Maqedonisë së Veriut, arritën pajtim për Aneksin e zbatimit të marrëveshjes drejt normalizimit.

Palët nuk e nënshkruan marrëveshjen, por BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara kanë thënë se pavarësisht se nuk është nënshkruar, ajo është marrëveshje e obligueshme për palët.

Marrëveshja, prej 11 nenes, nuk

përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë. Megjithatë, dokumenti kërkon nga të dyja vendet që t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat.

Dokumentet kërkon, po ashtu, nga palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.



garanton vetëmenaxhimin e komunitetit serb, qoftë për funksionimin me garancitë e nevojshme të Kishës Serbe në vendet e saj të kultit në Kosovë, duke e siguruar se në këtë proces jo të lehtë ai ka mbështetjen time më të plotë”, ka thënë Rama, duke treguar se me Kurtin ranë dakord që mbledhja e ardhshme e të dy qeverive të mbahet në qershor.

Edhe Lindita Nikolla, kryetare e Parlamentit të Shqipërisë, ka thënë se ka pasur një takim vëllazëror me kryeministrin Kurti. “Përgëzime kryeministrit Kurti për punët e mira që po bën

Qeveria e Kosovës si edhe durimin, qetësinë, maturinë dhe qëndrimet e guximshme për të ardhmen euroatlantike të Kosovës. Kuvendi nxiti e mbështet bashkëpunimin e shkëlqyer me Kosovën në të gjitha fushat dhe mbështetim vendimet e Qeverisë së Kosovës, si vendime të një qeverie të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe të një shteti sovran dhe të pavarur. Mbështetim perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe llojshmëri për njohjet e reja ndërkombëtare, anëtarësimin në Këshillin e Evropës, OKB e

organizata ndërkombëtare. Mbështetim dialogun midis Kosovës dhe Serbisë si rruga më e mirë dhe e vetme drejt njohjes së ndërsjellë mes dy vendeve, vlerësojmë planin evropian si një pikënisje e mirë për dialogun dhe mbështetim angazhimin në zbatimin e aneksit të këtij plani. Zbatimi i marrëveshjes midis Kosovës dhe Serbisë do të kontribuojë në forcimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe perspektivën e tij euroatlantike”, ka shkruar Nikolla në “Facebook”.

Kryeministri Kurti e falënderoi kryekuvendaren Nikolla për

mikpritjen e ngrohtë. E njoftoi atë me rezultatet e qeverisjes së deritanishme, që javën e kaluar mbushi dy vjet, për indikatorët ekonomikë, me theks te rritja e vazhdueshme e eksporteve dhe për raportet ndërkombëtare që dëshmojnë progresin në sundimin e ligjit, luftimin e korrupsionit dhe reformat e ndërmarra. U veçua Raporti i BE-së për Vëndin për vitin 2022, si më i miri ndonjëherë për Kosovën, e që konkludonte që Kosova nuk kishte asnjë fushë pa progres dhe asnjë fushë me regres.

Marrëveshja drejt normalizimit,

e përbërë nga 11 nene, nuk e obligon Serbinë ta njohë Kosovën, por kërkon nga të dyja vendet t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat. Ajo kërkon, po ashtu, nga palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.

## Artefakte nga Kosova do të paraqiten në ShBA

PRISHTINË, 26 MARS - Kosova, Shqipëria dhe vende të tjera të Evropës Juglindore do të jenë pjesë e ekspozitës "First Kings Of Europe", që organizohet nga një prej muzeve më të mëdhenj në ShBA, Field Museum of Natural History në Chicago.

Katër artefakte nga Muzeu Kombëtar i Kosovës do të paraqiten në ekspozitën që do të hapet më 31 mars në ShBA dhe do të vazhdojë edhe në Kanada. "FirstKingsOfEurope" bënë bashkë punën dhe tregimet e 26 muzeve dhe 11 vendeve të Evropës Juglindore.

Ekspozita ka si temë kryesore periudhën e formimit të elitave sociale dhe politike gjatë prehistorisë së vonë në Ballkan, nga komunitetet bujqësore egalitare të periudhës së Neolitit, tek elitat e konsoliduara të fundit të periudhës së Hekurit.



## Kurti takon drejtuesit e qendrave të LV-së në Kosovë dhe mërgatë, temë diskutimi qeverisja dyvjeçare

PRISHTINË, 26 MARS - Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur mbledhjen e përbashkët me drejtuesit e qendrave të saj në Kosovë dhe mërgatë si dhe me kryetarët e qendrave të Organizatës së Gruas për Vetëvendosje. Në këtë mbledhje morën pjesë kryetari i LV-së, njëherësh kryeministër i Kosovës, Albin Kurti, sekretari organizativ i LV-së, Alim Rama, koordinatori i qendrave, Valon Hoti, si dhe sekretarja organizative e organizatës së Gruas për Vetëvendosje, Agnesa Kastrati.

Për situatën politike Kurti ka folur rreth aktualitetit politik në vendin tonë. Ai ka thënë se javën që lamë pas qeveria ka shënuar dyvjetorin e saj "me shumë të arritura, punë të përfunduara e një mori sosh në progres e sipër".



Ai para përfaqësuesve të qendrave numëroi në hollësi të arriturat e qeverisë sipas fushave e ministrive përgjatë këtyre dy

vjetëve qeverisje. Çështjet organizative janë trajtuar nga drejtuesit e qendrave dhe drejtueset e GVV-ve në

qendra, me ç'rast është theksuar rëndësia e bashkërendimit organizativ në mes të strukturave organizative të LV-së

dhe organizatës të saj GVV-së. Aktivitetet e realizuara përgjatë muajit mars nga qendrat e GVV-së si dhe raportet e punës nga qendrat të muajve janar dhe shkurt janë diskutuar përgjatë këtij takimi. "Lëvizja që është duke qeverisur vendin për dy vjet ka dëshmuar se Republika e Kosovës mund të qeveriset ndershem, pa krim e korrupsion dhe mund të punojë për shtresat që kanë nevojë më së shumti. Qeverisja e mirë dhe e ndershme së bashku me organizatën e gjerë e strukturat dinamike në terren do të jenë binarët kah do të lëvizë Lëvizja. Këto dy vjet të suksesshme nuk ishin të lehta, andaj javëve, muajve e viteve në vijim na presin punë edhe më të mëdha si organizatë në mënyrë që sukseset të shumëfishohen", thuhet në njoftimin e LV-së.



## Haxhiu viziton ish-udhëheqësit e UÇK-së në Hagë: Ata janë të pathyeshëm, drejtësia do të triumfojë

HAGË, 26 MARS - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka qëndruar dy ditë në Hagë, ku është takuar me ish-udhëheqësit e UÇK-së të cilët po mbahen në paraburgim nga Gjykata Speciale. Haxhiu ka bërë me dije se kjo ishte një vizitë ishte shumë emocionuese dhe e pamjaftueshme për t'u çmallur me bashkëluftëtarët që po mbahen padrejtësisht në burg. "Bashkë me Dullën dhe Bajrën takuam shokët tanë të luftës, burrat e kombit, Hashimin,

Kadriun, bacën Jakup, Rexhën, Nasimin dhe Hysnium. Takimet ishin shumë emocionuese edhe pse këta burra të mëdhenj janë të fortë, të qëndrueshëm, të vërtetë në mbrojtje të luftës së drejtë të UÇK-së. U përqaftuam dhe u përhëndetëm me burrat më idealistë, stoikë e të pathyeshëm të popullit, me besim të plotë se së shpejti do të triumfojë drejtësia dhe ata do të kthehen fitimtarë e me kokën lartë si çdoherë, triumfatorë", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

## Vazhdon trajnimi i ekipeve shkollore në Drenas

DRENAS, 26 MARS - Vazhdon trajnimi i ekipeve shkollore, këtë radhë i prindërve në kuadër të projektit "Avancimi i përsheptuar i cilësisë së arsimit - Strategjia 5-vjeçare e arsimit

në komunën e Drenasit". Ky trajnim ka për qëllim fuqizimin e rolit të prindërve si aktorë shumë të rëndësishëm për menaxhimin e shkollës dhe rritjen e cilësisë në arsim.

"Avancimi i përsheptuar i cilësisë së arsimit - Strategjia 5-vjeçare e arsimit në komunën e Drenasit" mbetet projekt i pari në nivel vendi për nga mënyra e implementimit.



## “Shtrenjtimi i rrymës po na varfëron”

PRISHTINË, 26 MARS - “Me 200 euro në muaj sa i marr pension, si ta paguaj rrymën”, përgjigjet Rrahman Gjinovci nga Prishtina. Faturën e fundit të rrymës ai thotë se e ka paguar 60 euro. Me shtrenjtimin e paralajmëruar për rreth 15 për qind ajo mund t'i rritet për rreth 10 euro. “Rritja e tarifave të energjisë elektrike do të na varfërojë edhe më shumë”, thotë Gjinovci, i cili jeton me familjen e tij pesëanëtarëshe. Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) njoftoi të enjten se tarifën e energjisë elektrike do të rritet për rreth 15 për qind dhe se ato do të aplikohen nga 1 prilli deri më 31 mars të vitit të ardhshëm. ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e tarifave çdo vit. “Saktësisht se sa do të jetë rritja e tarifave të energjisë elektrike do të kuptohet në mbledhjen e radhës të Bordit të ZRRE-së, që do të mbahet brenda muajit mars”, tha kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, Ymer Zejnullahu, pas mbledhjes që u mbajt të enjten. ZRRE-ja ka paralajmëruar qysh më herët se është duke shqyrtuar një kërkesë të Kompanisë Kosovare për Distribucionin e Energjisë Elektrike - KEDS për shtrenjtimin e

rrymës. KEDS-i e ka justifikuar kërkesën e tij me rritjen e çmimit të rrymës së importuar si dhe me pamundësinë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për të prodhuar rrymë të nevojshme, sidomos gjatë sezonit të dimrit. Duke iu drejtuar gazetarëve, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se qeveria e tij do të bëjë të pamundurën që ta bëjë çmimin e energjisë elektrike “sa më të përballueshëm për qytetarët”. “Ne nuk u ndërhyjmë institucioneve të pavarura shtetërore siç është ZRRE-ja, por do të bëjmë krejt çfarë mund t’ia lehtësojmë qytetarit barrën”, tha Kurti, pa specifikuar më shumë. Nga shtatori i vitit të kaluar Qeveria e Kosovës i ka subvencionuar të gjithë qytetarët që shpenzojnë më pak energji elektrike në muaj krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Secili konsumator që kursen së paku 5 % të faturës përfiton subvencion sa dyfishi i përqindjes së kursyer. Ky subvencionim i qeverisë është ende në fuqi. Në Kosovë qytetarët, si gjetiu në botë, po përballen me nivel të lartë

të inflacionit. Viti i kaluar është përmbyllur me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni në shkurt ka qenë 10.5 për qind. “Shtrenjtë është. Nuk mund ta përballosh ngritjen e çmimit të rrymës se të ardhurat i kemi të ulëta”, thotë Latif Gashi nga Prishtina.

### Çmimi i energjisë në bursë ka rënë

Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavate rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavate në orë. Këtë diferencë ajo e importon nga jashtë. Çmimi i rrymës në bursën hungareze HUPX, nga ku importon Kosova, ka lëvizur vazhdimisht. Në gusht të vitit 2021 çmimi ka qenë 150 euro për megavat. Në gusht të vitit 2022 ka arritur në rreth 430 euro për megavat, por më vonë është stabilizuar në rreth 260 euro për disa muaj rresht. Të enjten, më 23 mars, çmimi ka qenë 105 euro për megavat.

### Gjukaj: Keqmenaxhimi i sektorit të energjisë rrit tarifën

Ish-drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës, Arben Gjukaj, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se ngritja e tarifave të energjisë elektrike në kohën kur çmimet e energjisë në bursën ndërkombëtare kanë rënë dhe kanë tendencë të vazhdojnë të bien, është e paarsyeshme. “Rritja për 15 për qind e energjisë elektrike që po u bëhet qytetarëve të Kosovës është pasojë e neglizhencës dhe mosgatishmërisë për t’u ballafaquar seriozisht me sektorin e energjisë në vend. Gjithashtu, kjo rritje i atribuohet edhe keqmenaxhimit të krizës energjetike, kohën e fundit, dhe abuzimeve në këtë sektor... joprofesionalizimit për t’u ballafaquar me këto sfida”, thotë Gjukaj, duke mos saktësuar se për çka ose për kë e ka fjalën. Me tarifën aktuale të rrymës konsumatorët që shpenzojnë mbi 800 kilovatë në orë brenda një muaji, paguajnë 12.5 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta,

ndërsa 5.9 centë gjatë tarifave të ulëta. Ata që nuk konsumojnë më shumë se 800 kilovatë, paguajnë 7 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta dhe 3 centë gjatë tarifave të lira. Kosova është e varur kryesisht nga termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” që prodhojnë rreth 500 megavate energji elektrike në orë. Për shkak të vjetërsisë së tyre me dekada, ato shpesh pësojnë prishje. Në vitin 2005 Qeveria e atëherëshme e Kosovës ka pasur një projekt për ndërtimin e një termocentrali të ri, por ai nuk është realizuar kurrë. Sipas ekspertëve, ndryshimet e herëpashershme në projekt, të bëra nga qeveritë e njëpasnjëshme, i kanë larguar investitorët. Për qeverinë e tashme projekti “Kosova e Re” është “i vdekur”, sepse nuk duhet investuar më në termocentrale me thëngjill. Këtë muaj Kuvendi i Kosovës ka miratuar Strategjinë e Energjisë për vitet 2022-2031, e cila parasheh rritjen e kapaciteteve për prodhim të energjisë së ripërtërishme.



## Hoti: 2.5 miliardë euro kursime të Trustit në mëshirë të tregut

PRISHTINË, 26 MARS - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka dhënë kritika për zhvillimin ekonomik. Ai ka numëruar disa nga dështimet e qeverisë Kurti. Sipas Hotit, qytetarët po përballen me rritje të çmimeve në të gjitha sektorët. “Në janar u rrit tatimi në pronë për 100%. Nga prilli rritet energjia me 15%. Çmimet e konsumit mbesin

të larta. Investimet kanë rënë në nivelin më të ulët për shumë vjet. Rritja ekonomike ka rënë nga 10 % në 3 % që nuk mjafton për ta mbuluar as amortizimin. Kursimet prej 2.5 miliardë eurosh në Trustin Pensional janë në mëshirë të tregut pasi Trusti nuk ka Bord. Banka Qendrore nga java tjetër mbetet pa guvernator. Investimet kapitale të shtetit

janë të papërfillshme pasi asnjë ministri nuk po punon gjë”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Ai thotë se askush nuk flet as nuk merret me zhvillim ekonomik dhe punësim. “Nuk e sheh një ngjarje të vetme ku promovohet një fabrikë e re apo një projekt i ri. Si u katandisëm kështu?!” ka shkruar ish-kryeministri Hoti.



# Fantazia fëminore e Steven Spielbergut



Nga Tanya GOLD

“The Fabelmans” (Njeriu i tregimeve), që është nominuar për 7 çmime Oscar, nuk është filmi i parë që Steven Spielberg ka bërë për veten e tij. Sepse të gjithë filmat e tij kanë elementë të kujtimeve personale: të fëmijës së vetmuar, të nënës së ndëshkuar, të babait të humbur. Edhe filmi i famshëm “Lista e Shindlerit” ka të bëjë me Steven Spielberg. (Ai është vetë Shindler, dhe viti 1993 ka qenë 1944-a e tij thotë David Thomson). “The Fabelmans” i jep finesë regjisorit sot 76 vjeçar, në një formë me të cilën është i kënaqur.

Është miti i krijimit të tij, dhe është e zakonshme që me dashurinë për veten, Spielberg ndjeu nevojën për ta realizuar një film të tillë. Sammy Fabelman jeton në periferi midis dy poleve, reale dhe metaforike: nëna e tij është artiste, bën muzikë, ndërsa babai i tij shkencëtar, ndërtonte makineri.

Të dy prindërit janë sipas mënyrës së tyre të papërbushur plotësisht. E ëma nuk mund ta ushtrojë dot artin e saj. Ajo është pianiste, por heq dorë për të rritur fëmijët e saj. Ndërsa babai nuk mund ta gëzojë familjen e tij, sepse shumë është i pasionuar pas punës.

Siç bëjnë artistët, Sammy mëson të krijojë një botë të cilën mund ta kontrollojë. Ai mund ta ndryshojë botën duke e filmuar atë. Pra të ndryshojë theksin e saj; vendin e tij në të. Sammyfilmon, në fillim pa e kuptuar, preken e nënës së tij me shokun më të ngushtë të babait të tij gjatë një udhëtimit me kamping dhe mëson se ajo e tradhton të atin. Insinuata – dhe ky është element më i vetëdijshëm në “The Fabelmans” – është se kinemaja është një medium helmues: se

ajo ha nga fryte nga pema e dijes dhe më pas dëbohet nga Parajsa. Por Sammy bie pre e fuqisë e saj të jashtëzakonshme për t’u transformuar.

Nga viktimë e bullizmit anti-semit në kohën e shkollës në Arizona, ai shndërrohet në një hero përmes kamerës së Sammy-t. Aq sa edhe ngacmuesi poshtërohet prej tij. Sammy e bën atë të duket i vogël. Gjithsesi turpi ishte i vetë Spielberg. Duke realizuar “The Fabelmans” ai shembet në fuqinë që përshkruan vetë.

Po pse nuk mund të jetë i sinqertë mbi shkallën e ambivalencës së tij? Sipas biografit të tij, Joseph McBride, Spielberg kishte aq turp nga të qenit hebre, sa që dikur bëri sikur nuk e njihje gjyshin e tij. “Befas gjyshi im, del nga shtëpia jonë dhe bërtet:”Shmuel! Shmuel! (Emri hebraik i Steven). Unë nuk ia përgjigja. Bëra sikur nuk e njoha. Po e mohoj emrin tim. Shoku im më tha “Ai po sheh nga ne. A mos e ka me ty?”. Unë ia ktheva “Jo, nuk jam unë”.

Ashtu si të gjithë hebrenjtë amerikanë të shekullit XX-të, Spielberg u rrit mes historive të Shoah. Prindërit e tij flisnin për të vazhdimisht. Dhe unë dyshoj se kjo ndjenjë sikleti u forcua nga humbja e lumturisë së familjes së tij, e cila u shkatërrua kur u zbulua tradhtia bashkëshortore e nënës së tij, me sa duket nga ai vetë.

Megjithatë, Steven ishte edhe i llastuar. “Ne nuk i thamë kurrë jo. Steve na drejtonte për çdo gjë”- deklaroi në një intervistë nëna e tij Leah. Pra një fëmijë i talentuar por plot tronditje shpirtërore, që u bë i madh aty ku dikur kishte qenë i vogël.

Motra e tij Anne shkroi skenarin për “Big”, në të cilin një djali 12-vjeçar i jepet trupi i një të trituri. Ai është i frikësuar, e si mund të

jetë ndryshe? Filmat e Spielberg kanë të bëjnë me ankthin. Kamioni (Dueli) ose Peshkaqeni (Nofullat) do t’ju shokojnë. Në filmat e Spielbergfëmijët e periferive janë të traumatizuar. Vetë ai kishte shumë frikë kur ishte fëmijë. “Unë kisha frikë nga hija e dorës sime”- kujton ai. Dhe kinemaja është një zgjidhje për këtë fobi, dhe kjo shpjegon monomaninë dhe aftësinë e tij si regjisor. Në këtë kuptim kinemaja është për të një akt mbijetese. “Nuk kisha asnjë mënyrë për t’i kanalizuar ato frikëra, derisa fillova t’u tregoja histori motrave të mia më të vogla. Kjo e largoi frikën nga mendja ime dhe e transferoi atë drejt e në shpirtin tim”- thekson regjisorin.

Më vonë Steven gjeti një audiencë më të madhe. “Një nga mënyrat më të mira për ta përballuar frikën është ta nxirrni atë nga vetja dhe t’ua jepni të tjerëve. Për shembull nëse keni frikë nga errësira, vendoseni publikun në një teatër të errët. Unë kisha një frikë të madhe nga oqeani. Pas filmit “Nofullat” të gjithë kishim frikë”- deklaroi ai. Një temë e dukshme trajtohet në filmat e tij: fëmijëria. “Unë mund të gjurmoj gjithmonë një ide që nga fëmijëria ime. Nëna është torturuar; babai ka humbur. Në filmat e Spielbergut ka pak politikë dhe nuk ka seks. Skena e seksit në Indiana Jones është një burrë që bën seks me nënën e tij. Ndonjëherë fëmija gjen babain që mungon. Dhe si një fëmijë, Spielberg është lakmitar, shpeshherë i pasjellshëm. Por ai mund të jetë jashtëzakonisht i mprehtë, pasi ka jetuar pjesën më të madhe të jetës në Hollyood dhe sepse gjithmonë nxjerr filma të rinj.

Ai ishte aq i sigurt se do të nominohet për çmimin Oscar për regjisorin më të mirë për

film “Nofullat”, sa që ftoi një ekip gazetarësh për ta filmuar atë duke parë nominimet.

Erdhën vetëm 4 çmime, përfshirë atë për montazhin më të mirë. Por asnjë për regjisorin më të mirë. Sipas Phillips, ky fakt e nxiti të niste xhirimin e filmit të tij të radhës.

Ai pati një sukses tjetër të madh me në vitin 1993 me “Listën e Shindlerit”: pranimin e përkatësisë së tij. “Ajo përvojë më motivoi të pajtohesh me të gjitha arsyet... Unë nuk u fsheha më nga hebrenjtë e mi. Dhe më bëri shumë krenar që isha hebre”- u shpreh ai në një dokumentar të vitit 2017.

Ai kishte dashur të filmonte në Aushvic, por e kishin ndaluar. Kampi i tij i rremë i përqendrimit në periferi të Krakov është ende atje. Unë e kam parë. Mendoj se me “Listën e Shindlerit”, ai u bëri një dëm të vërtetë hebrenjve, megjithëse në mënyrë të pandërgjegjshme: nazistët e tij janë sharmantë ndërsa hebrenjtë e tij një masë e heshtur dhe e terrorizuar.

E mbani mend skenën e fundit: imponimin e një fundi shëlbyes, që përjetohet si më etmerrshëm se çdo gjë që kishte ndodhur më parë? Si mund ta bënte një film të tillë dhe më pas t’i humbiste kuptimin? Një miku i tij regjisor pa një montazh të përafërt të “Listës së Shindlerit”: ai nuk pa asnjë kolonë zanore, asnjë fëmijë me një pallto të kuqe dhe asnjë fund shëlbyes.

Ai mendoi se ishte një kryevepër. Por ky është Spielberg. Ai nuk mund të ndalojë së modifikuari sepse nuk i beson audiencës, por vetëm vetes. “Unë jam vetë publiku”- thotë ai.

Ankesa e zakonshme për Spielberg është se një fëmijë i talentuar që bën kinema për fëmijë më pak të talentuar. Ai e ka kthyer kinemanë nga forma e

sofistikuar e artit të viteve 1970 në një lloj anestezie.

Pauline Kael thotë se problemi nuk është Spielberg por bashkëpunëtorët e tij: “Të gjithë të tjerët kanë imituar fantazitë e tij, dhe rezultati është një infantilizim i kulturës”. Përgjigja e tij ndaj kësaj është zakonisht prekëse “Unë mendoj se disa njerëz do të donin që unë të bëja një film që eksploron anën e errët, dhe që nuk ofron një përgjigje të lehtë për ta bërë audiencën të ndihet më mirë kur të rikthehen tek makinat e tyre.

Nëse ata kritikë duan më shumë dhimbje në filmat e mi, mund të më japin 2 milionë dollarë –kaq do të duhej për të bërë një film për dhimbjen – dhe unë do ta bëj atë film”. Por mua më pëlqen të mendoj se e vetmja gjë që qëndron mes tij dhe madhësisë është vetë-mashtrimi i tij, këmbëngulja e tij për dashamirësinë e tij.

Por gjëja e tmerrshme është se e di se ai mund t’ia dalë. Dhe do të doja që ai ta bënte. Pyes veten se sa e kupton veten. Pavarësisht bukurisë së tij, The Fablesman, nuk sugjeron se kjo gjë ndodh. Bashkëshortja e tij, aktorja Kate Capshaw, e cila ka luajtur në filmat e tij Indiana Jones dhe Temple of Doom, e pyeti një herë se çfarë ndodhi me karrierën e saj.

“Ai më tha: Ti nuk duhej të kish një karrierë. Ti duhej të ishe me mua”. Kështu i ndodhi pikërisht nënës së tij: ishte burimi i ankthit të saj.

Po kështu shprehet në “The Fabelmans”. Por unë nuk habitem që ai e harron këtë. Filmat e tij nuk trajtojnë marrëdhëniet e personazheve me njëri-tjetrin. Ata merren me marrëdhënien e Spielberg me veten. Puna e tij duket gjithnjë e mbetur pas në peizazhin vezullues dhe kufizues të fëmijës. / “Unherd” – Bota.al

AJAZ EMINI - Ditar (III)

# NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

## RRUGA DREJT OPERACIONIT TË FORCAVE ALEATE (OPER- ATION ALLIED FORCE) TË NATO'S SHQIPËRI- KOSOVË

Fillova interesimin për kyçe në Batalionin "Atlantiku", që po rritej dita ditës nga të rinjtë dhe të rejtat shqiptare të diasporës këtu në SHBA, për t'i shkuar në ndihmë vëllezërve dhe motrave shqiptare në Kosovë, si dhe për ta ndihmuar UÇK-në në frontet e luftës kudo që lypej kundër armikut shekullor serb. Vura kontakte me disa aktivistët e çështjes kombëtare që po njihja, të cilët kishin njohuri më të qarta në lidhje me këtë organizim. Isha duke pritë përgjigjet nga shokët e bisedës, por në lidhje për interesin tim ende nuk e kisha njoftuar familjen time më të ngushtë pasi se e dija shumë mirë reagimin e tyre. Meqenëse ende nuk i kisha tregu asgjë për planet veti bashkëshortes dhe fëmijëve, rastësisht duke shfletuar dhe lexuar diçka në një gazetë Kroate, papritmas duke shfletuar aty pashë një kërkesë ku po kërkohej përkthyes shqip-anglisht-serbo/kroatisht dhe ishte diçka që më tërhoqi vëmendjen duke menduar se ndoshta kjo për mua do të ishte rruga më e mirë që të kyçem në ndihmë direkte të popullit tim nga vija e parë e frontit me Forcat e Ushtrisë Amerikane. Unë gjithashtu nuk kisha ndonjë eksperiencë ushtarake, pasi se nuk kisha kryer shërbim ushtarak as këtu në Amerikë e as në ish-

Jugosllavi, edhe pse ishte obligim në ish-Jugosllavi. Nga fundi i Shkurtit 1999 së bashku me familjen: Shahdijen, Liridonën dhe Mimosën, vendosëm që të shkojmë në vizitë të balldëzja Ajnishahe Hoxha-Iljazi e cila jeton në Bruklin të Nju Jorkut, por, me një qëllim që të takojë dhe bashkëbisedojë me aktivistët nga Nju Jorku të cilët i dinin gjërat shumë më saktë. Në të arritur në Nju Jork, gjithmonë e kisha si shprehje që pas arritjes përmendje të shkojë e të blejë edhe shtypin ditor shqiptar që shitej aty afër. Mirëpor kësaj here sipas të gjitha gjasave, me të kuptuar Ajnishaheja e motra e Shahadijes se po shkonim në Bruklin tek ajo, para arritjes tonë atje, ajo kishte shkuar dhe më kishte blerë një numër të përditshmes shqiptare "Illyria" nga botuesi Harry Bajraktari, patriot, lobist dhe aktivist i madhë i çështjes kombëtare shqiptare e cila po botohej në Nju Jork. Gjatë mbremjes pas bisedës me familjarët fillova ta e shfletojë gazetën që më kishin blerë, për të parë lajmet më të reja shqiptare. Gjatë shfletimit për menjëherë më ra në sy konkursi për kërkesën e përkthyesve shqiptarë nga Departamenti i Shtetit Amerikan, ku shkruante se po kërkoheshin urgjentisht përkthyes shqiptarë për



t'iu bashkangjitur Armatës Amerikane në misionin e tyre për në vendet Ballkanike! Për të shkuar përtej oqeanit në vendet e Ballkanit, atje ku veçse kishin filluar zbarkimin e trupave të Armatës Amerikane së pari në Maqedoni, e më vonë edhe në Shqipëri. Po, sepse tani po pritej edhe sulmi i tyre mbi forcat paramilitare-ushtarake serbe nga NATO'ja, pasi se pushtetarët amerikan ishin lodhur nga rrenat e përditshme të Millosheviqit! Departamenti i Shtetit Amerikan nuk kishte besim në premtimet e dhëna nga lideri serb, dhe mu për atë opcioni i vetëm amerikan ishte ndërhyrja direkte e NATO's kundër forcave gjakatare serbe, apo siç i quanin ata veten të forcave jugosllave! Të nesërmen nëpërmjet të telefonit e kontaktova Departamentin e Shtetit Amerikan për kërkesën e përkthyesve për në Armatën Amerikane. Në anën tjetër të telefonit u paraqit personi i quajtur Ivan Podnari, i cili ishte menaxher për një kompani gjigande amerikane të quajtur TRW, e cila ishte kompania që kishin marrë kontratën për pranimin edhe egzaminimin e përkthyesve për Departamentin e Mbrojtjes së Shtetit Amerikan, dhe pastaj për t'i dërguar në arenën e vendeve Ballkanike. TRW ishte një kompani e madhe dhe shumë prestigjioze e cila po mirrej me shumë lemi të industrisë si dhe intelecencës. Meqenëse kisha eksperiencë shumëvjeçare në profesionin linguistik dhe eksperiencën e përkthimeve dhe interpretimeve nëpër zyrat e ndryshme të shtetit dhe emigracionit, gjykatave të ndryshme si dhe agjencive të ndryshme amerikane, thujajese gjithkund ku ishte nevoja më ftonin të përktheja, qëlli, isht për t'ua lehtësuar shërbimet të posa ardhurve shqiptarë por edhe të kombësive të tjera dhe të gjithë atyre që kishin nevojë për përkthyes për gjuhët ballkanike. Pyetja e parë e Ivanit ishte se çfarë eksperiencë kisha për

detyrën që po ofronin? I spjegova eksperiencën e përkthimit që kisha bërë si punë në të gjitha zyrat e ndryshme pas orarit tani 20 vite rresht! Pasi se ndëgjoi përgjigjen time të eksperiencës se çka kisha punuar si linguist, ai disi mbeti i mahnitur. Me eksperiencën që kisha në lëminë e përkthyesit, interesimi i Ivanit për mua ishte tepër i madhë, i cili nuk pritoi aspakë dhe përmendje më ofroi detyrën dhe më pyeti se kur mundë t'ia fillojë punës? Gjatë kësaj kohe kur bisedova me të, unë isha menaxher në një restorant të njohur italian në Cleveland të Ohio's, e që quhej "Caffe D'Oro". Po mendoja gjithashtu edhe për Shahadijen e cila ishte menaxhere e njohur, për punën që po kryente shumë herë edhe ishte shpërblyer në Hotelin e mirënjohur "Marriot" të Clevelandit! Ivanit i thashë se më duhet pakë kohë për të vendosur, më së pakti nja dy javë pasi se t'i njoftojmë dhe vendet e punës që kishim! Sipas rregullave të punës në Amerikë, zakonisht para ikjes nga puna duhesh ta njoftosh kompaninë më së paku 2 javë më herët që t'iu japësh mjaftë kohë për të gjetë zvendësimin tëndë me punëtorin tjetër. Po në të njëjtën kohë edhe vajzat Liridona dhe Mimoza ishin nxënëse në shkollën fillore, për të cilat duhej parë se si me ia bërë. Iu drejtova Ivanit se unë po vijë, por me kusht që edhe Shahadija të më bashkangjitet pas qershorit 1999, menjëherë pas përfundimit të vitit shkollorë, atëherë kur edhe fëmijët dalin në pushimin verorë. Përsëri i kërkova që të më japë pakë kohë, që të paktën ta njoftojë dhe t'i japë 2 javë kohë restorantit para se të largohesh nga puna, kudo të punoja dhe të ushtroja dikend tjetër për të më zvendësuar (sipas rregullave të punës), edhe për më saktësisht i thashë se pasi se të këthehem në Cliveland do të lajmërojë. Me të këthyer në Cleveland nëpërmjet telefonit e kontaktova pronarin e restorantit, të cilin e njoftova për planet që do



të ndërmerja. Në fillim ishte krejtë normale, u prek shumë se si kisha mundë që aq shpejtë edhe aq lehtë të vendosi që të largohesh nga një punë e sigurtë që kisha. Nga këtu ku kisha besim jashtëzakonisht të madh, për të ikë e me u kyçur për një profesion krejtë tjetër dhe me një pikëpyetje të madhe që nuk po e dija se ku po shkoja? Meqenëse pronari i restorantit ishte me prejardhje arabe, ai përmendje më pyeti se: "A e kisha mendu ndonjëherë pa marrë parasysh pagesën, sepse ju kenit fëmijët e vegjël. Sa përkthyes janë vrarë në profesionin e tyre me Ushtrinë Amerikane në Irak dhe Afganistan? Vetëm në Irak janë vrarë mbi 360 përkthyes, dhe janë lënduar mbi 1200 prej tyre. Në Afganistan gjithashtu janë vrarë mbi 300 përkthyes!" "Po" i thashë, "E di një shumë mirë se për ku po nisem, e di një edhe rrezikun që mundë të kem, ndoshta do të jemi edhe në vijën e parë të frontit së bashku me ushtarët amerikan që do të shkojnë, mirëpo kjo është ftesa e atdheut tim që po rënkon. ATDHEU THËRRET : atje ku shumë njerëz po maltretohen, po dhunohen, po vriten dhe po masakrohen, fëmijë, gra, pleq dhe i tërë vendi po digjet në flakë nga neofashistët serb, JA SOT JA KURRË!

Meqenëse pronari ishte nga Lindja e Mesme, ai ishte nga Palestina dhe i kishte shumë mirë të njohura vuajtjet dhe luftën për liri. Në fund të bisedës pas këshillave të tij na dëshiroi rrugë të mbarë, me shumë suksese edhe kthim të shëndetshëm dhe të sigurtë në SHBA, dhe më tha: "Na je i mirëseardhur kurdo që të kthehesh, eja përsëri në punën tuaj këtu ku je, ne të duam që të mbetesh pjesë e biznesit tonë!" Gjatë kësaj kohe isha mjaftë aktiv edhe në Shoqatën Shqiptaro Amerikane të Klivendit, dhe të nesërmen unë me disa pjesëtarë të tjerë të komunitetit shqiptarë ishim të ftuar: unë Ajaz Emini, Hasan Bakia, Valter Vajushi, Burhan Vneshta dhe Dr. Ismail

Dreshaj për në një emision radiofonik nga gazetari i mirënjohur Noah Adams për emisionin e tij

"All Things Considered" (Të Tëra Gjërat e Konsideruara), që ua kishin kushtuar aktualiteteve më të reja në Kosovë, për Radion Publike Kombëtare (National Public Broadcasting), radio e cila ndëgjohet në tërë Kontinentin Amerikan, i cili stacion mbahet nga vetë kontributi i popullatës amerikane. Në këtë program të radios, ne komuniteti shqiptarë i Clevelandit shfaqëm arsyen dhe kërkesën se pse duhej ndërhyrja e ushtrisë amerikane me NATO'n në Kosovë, duke ia sqaruar qëllimin për të mbrojtur, dhe për të shpëtuar popullin e pa mbrojtur shqiptarë. Ky emision u transmetua disa ditë më vonë në rrjetin publik për një audiencë në tërë Kontinentin Amerikan. Pas radio intervistës me gazetarët e NPR, që të gjithë ne u përshëndetëm edhe ikëm secili për në shtëpi të vetë. Gjatë rrugës për në shtëpi përsëri më mori në telefon Ivani me të cilin tani veçse kisha pasë disa telefonata nga zyra e tij në Washington, i cili më tha: "Po ju telefonoj sepse ti na duhesh urgjentisht, dhe dua që të niseni sonte apo nesër më së voni, për në Washington DC, për tek ne sepse po na kërkohet urgjentisht përkthyes shqiptar nga Komanda Ushtarake në Shqipëri!" I thashë "Më fal, por duhesh të më presish siç të kam thënë më parë, sepse më duhet më tepër kohë për derisa të ndahem nga puna", ai më thot: "Tani çdo gjë është kryer, sepse ne ta porositëm biletën e fluturimit edhe hotelin për ty edhe Shahadijen, edhe prej aeroportit në Washington, e keni të paguar edhe taksin, gjithashtu edhe prej shtëpisë në Aeroportin e Clevelandit dhe nga Aeroporti i Washingtonit për në hotel si dhe ushqimin, që të gjitha janë paguar. Pas aritjes në hotel ne do të vijmë për t'iu marrë me makinën tonë, dhe do t'iu dërgojmë për t'i kryer të gjitha punët dhe obligimet që duhet kry para udhëtimit për në bazën e Armatës Amerikane të Fort Benning ne Georgia (Xhorxhia)." Pas aritjes në shtëpi i tregova Shahadijes për telefonatën që më kishte ardhë, edhe i thashë se duhet bërë gati sepse ne duhet që të nisemi nesër për në Washington DC. Ajo për një kohë mbeti e shtanguar, shumë e befashuar, por edhe e frikësuar, dhe në fillim u mërzhitem sepse nuk kishte për të qenë aq e lehtë kjo ndarje jo e zakonshme, dhe pa e ditur destinacionin tonë të fundit, duke i lënë pas vete gruan me fëmijët të një moshe krejtë të mitur, dhe pa e ditë përfundimin e kësaj rruge se ku do të na çojë e ndoshta ishte edhe rrugë e pa fundë...

Pas bisedës familjare, kontaktova pronarin e restorantit edhe i tregova se ç'po ndodhte, se jemi thirrë që urgjentisht të nisemi nesër për në Washington DC, në lidhje me detyrën që kishim marrë përsipër

me qëllim që t'i bashkohemi Forcave të Armatës Amerikane për në destinacion drejt Kosovës së përgjakur. Në fillim ai u habitë pa masë, se si është e mundur që aq shpejtë po largohesha, por përsëri e mbajtë veten pa thënë asgjë përpos se na dëshiroi të gjitha të mirat edhe kthim sa më të shpejtë në Cleveland.

Gjithëçka po lëvizte shumë shpejtë, pasi se asnjëherë nuk na shkoi mendja se do të ndodhë kështu në këtë mënyrë, nuk ishim të përgaditur që të nisemi mbrenda një kohe kaq të shkurtër, kisha planifikuar të paktën të kemi edhe 2 javë!

Të nesërmen në mbrëmje u nisëm nga Aeroporti i Cleveland'it "Hopkins International Airport" së bashku me Shahadijen, u nisëm për në Washington DC. Në të mbërrirë në Washington DC, morëm taksin dhe shkuam në hotelin që na kishin rezervuar diku në afërsi të Aeroportit "Dulles International Airport", ashtu siç na thanë në telefon. Hoteli ishte rezervuar për dy netët e ardhshme, derisa të kryenim obligimet para nisjes për në rrugën e mëtejme! Herët gjatë mëngjesit erdhi Ivani me një shok tjetër të punës për të na marrë dhe për të shkuar në zyrat e tyre. Rruga deri në zyrat e tyre zgjati rreth 40 minuta, ata ishin të vendosur në Farfakte Virginia's, e që ishte në periferi të Washington DC. Kompleksi ku shkuam ne ishte shumë modern dhe mjaft i avancuar e që më përngjante sikurse nga filmat "007" të Xhems Bondit, ku në secilën derë ishte hymja me çip kartela! Mbrenda zyreve të tyre takuam edhe 10 përkthyes të tjerë shqiptarë të moshave të ndryshme të ardhur nga qytetet e ndryshme të Amerikës. Në fillim na i morën shenjat e gishtërinjëve si dhe bëmë regjistrimet, pastaj ndërhyëm në testet gjuhësore dhe kontrollin e Qartësisë së Sigurisë Shtetërore Amerikane (Security Clearance), sepse do të kishim shumë punë konfidenciale, ku po bëhej kontrolli i të gjitha të dhënave të secilit prej nesh mbrenda 10 vjetëve të fundit për të cilën edhe nga një dënim i thjeshtë mundë që të diskulifikonte për punësim për Departmentin e Mbrojtjes së Shtetit Amerikan.

Në ditën vijuese na mbeti për të kryer dhe vetëmse kontrolli mjekësorë, pas së cilës do të ktheheshim përsëri për në shtëpi. Pas kthimit në shtëpi mua mu dhanë vetëmse 2 netë që të rrijë aty, dhe pastaj për të vazhduar rrugën për në bazën ushtarake të Fort Benning's të Georgia's (Xhorxhia), dhe më vonë prej ku do të niseshim në fillim për në Shqipëri, e më vonë sipas të gjitha gjasave edhe për në Kosovë, sepse ai ishte qëllimi i destinacionit.

*-E premtë, 16 prill 1999*

Ishte ditë e premtë, gjithëçka ishte e mërzitë-shme, edhe qielli siç dukej vuante, po ndaheshim nga familja dhe shoqëria për një kohë të pa përcaktuar. Gjatë tërës të ditës u mundova që të kryeja obligimet familjare që kisha, me pagesat e shërbimeve të ndryshme si dhe kompletimin e çfarëdo dokumenti

që iu duhej për në të ardhmen për t'ia lehtësuar punët familjarëve. Me vete kisha paketuar shumë pakë sende, veçse pasaportën me dokumentet e udhëtimit dhe disa gjërave elementare si pasta dhe brusha e dhëmbëve, fërça dhe ngjyra e zezë e këpucëve si dhe disa palë të veshjeve të brendshme pasi se sendet tjera do të jenë ato ushtarake që do të na ipeshin mbrenda disa ditësh në bazën e Armatës së SHBA në Fort Benning. Në përcjellje timen tani kishin ardhë të takohen edhe të gjithë pjesëtarët tjerë të familjes. Rreth orës 18:00 të mbrëmjes, Shahadija me bukuroshet e babit, i hypëm makinës për t'u nisur për në Aeroportin Ndërkombëtar "Hopkins International Airport" të Clivlend'it i cili ndodhej veçse disa minuta largë shtëpisë që kishim.

Për atë edhe nuk thirrëm taksitaxi edhe pse e kisha të paguar. Në aeroport arritëm në orën 18:10, bëmë përqafimin lamtumirës, ku në sytë e Shahadijes shifej mërzija më e madhe, iu panë edhe lotët, kurse vajzat edhe ato ishin të mërzitura por më tepër të habitura sepse nuk dinin saktësisht se ç'po ndodhëte me ne. U nisa drejtë dyerve të aeroportit për të bërë kontrollin duke i dhuruar puthjet e fundit më të dashurve të jetës në ajër. Meqenëse nuk kisha shumë sende, e kisha vetëm një çantë në krahë që nuk e dorëzoja te valixhet por e mora me vete që mos të presë dhe pas arritjes në destinacionin tim ku do të ishte edhe më lehtë, sepse nuk do të kisha nevojë për pritjen kur të vinin valixhet. Nga pika e kontrollit të parë deri te dera e aeroplanit ishte një rrugë disa minutëshe që po hecja përbrenda aeroportit. Orari i fluturimit ishte për në orën 20:55 të mbrëmjes, aty ku kisha mjaft kohë për të pritur. Dikur pas 15 minutash qëndrimi aty e thërras shtëpinë për të kuptuar se si po ndiheshin Shahadija me fëmijët në shtëpi. Biseduam gjërësisht dhe dikur rreth orës 20:30 para meje filloi grumbullimi i shumë udhëtarëve që kishin po të njëjtin fluturim, dhe pas 10 minutash stjuardesat na dhanë lejen që të futeshim mbrenda aeroplanit.

Udhëtimi Cleveland-Washington DC ishte i shkurtër, veçse një orë e gjysëm, dhe aty rreth orës 22:30 arritëm në Aeroportin Ndërkombëtarë "Dulles" të Washington DC. Nga aeroporti mora taksin dhe në orën 23:15 arrita në Hotelin "Fairfield", atje ku duhej të çlodhesha dhe të bëhem gati që të nesërmen në orën 8:30 në mëngjes të vazhdojë me orarinin e ditës që më kishin caktuar për tutje.

*E shtunë 17 prill 1999*

Pasi u zgjova në orën 8:30 të mëngjesit erdhi makina e TRW që të më merr, dhe për të shkuar në zyrat e kompanisë aty ku i dhamë të gjitha informatat personale si dhe bëmë edhe nënshkrimin e marrëveshjeve të ndryshme dhe kontratës së punës. Kjo ndodhi para nisjes për në bazën ushtarake. Gjatë kësaj kohe në këtë zyrë u bë edhe "Qartësia e Sigurisë" (Security Clearance) pas së cilës do të na ipej mundësia që të jemi punëtorët e besueshëm. Me këtë do të kemi të



drejtën që të punojmë edhe me dokumente dhe biseda më sekrete që ishin, si dhe për kryerjen e punës edhe në dokumentat dhe përkthimet më sekrete. Gati se gjithëçka ishte konfidenciale për Ushtrinë Amerikane! Pas plotësimit të këtyre dokumentave na dërguan për të bërë edhe kontrollin e përgjithshëm mjekësor për të pa se a ishim me shëndet në gjendje të shëndoshë dhe të aftë për t'iu bashkangjitë Forcave të Armatës Amerikane. Gjatë kësaj dite pushë se prej të gjithëve sa ishim më pare, tani kishim mbetë vetëm se një grup prej 6 përkthyesve shqiptarë (4 meshkuj dhe 2 femrave). Kjo ishte një ditë e gjatë dhe tepër e mërzitëshme, ku nga lodhja dhe stresi më kapi edhe kokëdhimbja. Pasi i kryem të gjitha obligimet, përsëri na kthyen në hotel për të kaluar natën e fundit në Washington DC, që të nesërmen për të vazhduar fluturimin për në Atlanta të Xhorxhisë (Georgia), e pastaj me makina ushtarake për të shkuar në Bazën e Armatës Amerikane të Fort Benning të Xhorxhisë (Georgia).

*E diel 18 prill 1999*

Posa u zgjuam, u bëmë gati dhe zbritëm poshtë te hyrja e hotelit ku erdhën edhe na morën menaxheri Ivan Podnar dhe një mbikqyrës tjetër të TRW, të cilët kishin pasë punuar me përkthyes në Bosne dhe Hercegovinë. Gjatë rrugës për në aeroport shkëmbyem mendime të ndryshme nga puna dhe eksperiencia e tyre si përkthyes. Porosia dhe këshilla e tyre ishte mbajtja e një ditari që të përshkruanim për aktivitetet tona ditore si dhe të bënim sa më shumë fotografi, sepse ato do të na mbesin kujtime që rrallëkush do të ketë rastin t'i përjetojë në jetë! Nga ata më lindi ideja e këtij ditari që po e shkruajë dhe fotove të cilët po i shfletoj me ju tani! Para ndarjes prej tyre në Aeroportin "Dulles" të Washington DC, na porositën që për çfarëdo problemi që të kishim të kontaktojmë me Ivan Podnar i cili ishte me prejardhje Kroate, i cili ishte një person me eksperiencë të lartë dhe i mirëkuptueshëm për bashkëpunim. Fluturimi për në aeroportin e Atlantës ishte i rehatshëm dhe zgjati pakë më shumë se 2 orë.

Në Aeroportin e Atlantës "Hartsfield-Jackson" (Hartsfield-Jackson Atlanta International

Airport) mbërritëm pas dite, aty ku po na pritnin ushtarakët me makinë civile. Nga nisja prej aeroportit të Atlantës bëmë rreth dy orë udhëtim me makinë, derisa arritëm në Bazën e Armatës Amerikane të Fort Benning (Fort Benning, Military Base) e cila ishte afër Kolumbusit të Xhorxhisë (Columbus, Georgia).

Klima në Xhorxhia ishte shumë më e mirë se në Cleveland dhe Washington, ishte e nxehtë e cila ndryshonte shumë nga vendet tona prej nga kishim ardhë, nga veri-lindja e SHBA'së. Ishte një ditë e bukur me diell thuajse si me qenë ditë vere. E gjithë baza ushtarake ishte e rrethuar në tela me gjemba, në hymje na ndaluan roja ushtarake dhe pas kontrollit të dokumentacionit na u leju hyrja. Pas hyrjes kuptuam se tani ishim pjesë e Forcave Ushtarake Amerikane, baza ishte me një sipërfaqe dhe hapsirë shumë të madhe thuajse aty ishte një qytet me përmasa shumë të mëdha. Aty kishin shkollat për fëmijët e personelit ushtarak, banesat për familje të ushtarakëve, hotel, spital ushtarak, pjesët e ndryshme për ushtrime luftarake, fushat sportive, restorante, shitoret e mëdha krejtë njejtë sikurse jashta telave të bazës, përveçse secilin person që po shihnim ishin në uniformë ushtarake dhe lirishtë mundë të themi se ai ishte një qytet ushtarak në vete.

Pas hyrjes mbrenda bazës, në fillim na dërguan në një magazinë aty ku na furnizuan me çarçafë, qebe, jastuk dhe na u dhanë paketimet e ushqimit të famshëm ushtarak MRE (Meal Ready to Eat/ Ushqim i Gatshëm për t'u Ngrënë), pastaj na dërguan në barakat ushtarake të cilat thuajse ishin krejtë të braktisura, me një numër të vogël ushtarësh aty ku do të bënim gjumin dhe të kalonim netët në vijim.

*E hënë 19 prill 1999*

Në mëngjes na zgjuan herët, ishte rreth orës 6:00, na orientuan që të shkojmë në menzën ushtarake për të ngrënë mëngjesin e parë me ushtarët e Armatës Amerikane, dhe pas mëngjesit në orën 7:30 me autobus ushtarak na dërguan me një vend tjetër, por mbrenda bazës ushtarake aty ku bëmë një udhëtim bukur të gjatë deri te spitali ushtarak, për t'i kryer kontrollet mjekësore nga personeli

ushtarak. Baza e Armatës Amerikane të Fort Bnning ishte ndër bazat më të mëdha ushtarake në botë, si dhe më e madhja bazë amerikane, me rreth 500 km2, bazë e cila ishte themeluar qyshë nga viti 1918 në Xhorxhia afër qytetit të Kolumbusit (Columbus) dhe kufirit me Alabamën. Kjo bazë po përdorej kryesisht për këmbësorinë dhe artilerinë e Armatës Amerikane.

Kontrolla mjekësore për ne sot kishte qenë vaksinimi, për të cilën në të hyrë mbrenda na kërkuan kartonat e vaksinimit, karton i cili jipej secilit banor amerikan që nga lindja për të patur një evidencë se çfarë vaksine kanë marrë, si një lloj letërmjotimi të vaksinave që është edhe i obligueshëm për të pasë mundësinë për t'u regjistruar në shkollë. I tregova mjekut ushtarak se unë nuk kisha karton vaksinimi me vete edhe pse i kisha marrë të gjitha vaksinat sipas vaksinimit që duhej marrë, sepse asnjëherë nuk na kishin dhënë atë kartë vaksinimi! Mjeku ushtarak mu drejtua mua edhe më tha: "Mos u mërzi te djali i ri, pasi se nuk e paske me vete, tani ne do t'ua bëjmë përmënjëherë nga një më të ri dhe ruaje mire. Shkoni atje dhe hyni në rresht me ushtarë të tjerë, edhe hiqni këmishat nga trupi që t'ua bëjmë sa më shpejtë formalitetin! Para meje në rresht ishin shumë ushtar, por ky që ishte para meje ishte një ushtar me ngjyrë. Ishte i madh edhe më gjatë se mbi dy metra i lartë, por edhe në peshë mjaftë i shëndoshë. Derisa po i afroreshim ngadalë tavolinës kryesore të mjekëve të cilët ishin të stacionuar në të dy krahët tonë, e ne ishim te rreshti në mes tyre, ushtari që ishte para meje, pra ai me ngjyrë, ç'do këmbë që pë lëviznim te para edhe po i afroreshim tavolinës së mjekëve, filloi të dëneste. Mendova se mos është i sëmurë, dhe sa më tepër që po i afroreshim mjekëve ai filloi ta ngrisë zërin më tepër, mandej po mendoja se e kishte për hajgare mirëpo sa me tepër që po afroreshim po i rritej edhe zëri i tij. Kur arritëm te caku ku mjekët ushtarak po jipnin vaksinat, ai filloi me qa me plot zë, deri në qiell po ndëgjohej qarja e tij. I shkreti e kishte frikën nga vaksinimi, zëri i vajit të tij na e dha gazin që të gjithëve që ishim aty.

E harruam therjen e gjilpërave në të dy krahët tonë, edhe atë 3 në njërin krahë dhe 4 në krahun tjetër,

ku edhe në të dalur na bënë edhe kartat e reja të vaksinimit dhe na thanë që t'i ruajmë këto kartat e vaksinimit sepse për ndryshe na duhet që t'i hyjmë të njejtimit formalitet nga fillimi. Gjithashtu na porositen që të nesërmen të paraqitemi në kontrollë për vaksinën e TBC si dhe për ndonjë reaksion tjetër. Pas vaksinimit për imunitet, pas dite na dërguan te dentisti që të bëjmë edhe kontrollën e dhëmbëve, edhe disa që kishin ndonjë dhëmb të prishur e ndalnin për derisa ia rregullonin dhe pastaj mundë që të vazhdonin për më tutje. Pas kontrollit të dhëmbëve përsëri na kthyen në barakat e kazermës ku kaluam edhe natën tjetër. Gjithandëj ku shkonim nuk pamë asgjë tjetër përveçse uniformës ushtarake. Ne ishim më të veçantë me veshëmbathje civile. Gjithëkund ku shkuam ky personeli ushtarak tregoi rrespekt të veçantë ndaj nesh, na e bënë qëndrimin tonë aty shumë të lehtë sikurse të kishim qenë pjesë e tyre me vite të tëra së bashku, edhe atë na ofruan që të dalim në qytet me to për darkë dhe të ngrisim nga një gotë për mirëqenie dhe miqësinë së bashku me to! Na dërguan në një restorant 10-15 km. prej ku ishim, ishte një restorant i mirë sigurisht me pronarë nga Italia i cili quhej "Caponi", e i cili kishte kuzhinë të mirë italiane. Aty kaluam çaste shumë të mira deri në orën 22:00 të mbrëmjes, atëherë kur ishte edhe koha e kthimit për në kazermën ushtarake ku po qëndronim.

*E martë 21 prill 1999,*

Sot u zgjuam rreth orës 7:00 të mëngjesit, edhe kjo ishte një ditë e bukur me diell dhe e ngrohtë. Në orën 7:30 na dërguan aty afër barakave tona në magazinën e uniformave ushtarake, ku do të bënim edhe mobilizimin ushtarak. Në magazinë ishin dy ushtarake që po punonin aty të cilat na dhanë të tërë veshëmbathjen duke filluar nga: disa palë çorape, këpucë vere, këpucë dimri, një komplet maica të mbrendëshme, 2 këmisha kamuflazhe, pallto vere, pallto dimri, pallto për shi, matarë uji, maska- mbrojtëse kundër sulmit bio-kimik, xhaketa anti plumb, kapela, helmata, thesin e fjetjes, dorezat e verës dhe të dimrit, si dhe gjërat higjienike dhe një thes ku duhej që të paketoheshin të gjitha këto sende! Që të gjithë mbetëm të ngujuar pasi se nuk kishim idenë se si me i paketu të gjitha këto

sende me një thes. U munduam duke u treguar secili më i mençur se tjetri, por nuk ia arritëm qëllimit sepse ende shumë sende na mbeteshin jashta thesit! Ushtarët magazinierë duke na parë se si po mundoheshim dhe pa sukses, njëri prej tyre na u afrua dhe na tha ta shikojmë me vëmendje atë se si palohen të gjitha sendet edhe të gjitha të futeshin shumë lehtë po në të njejtin thes. Ai këtë gjë e bëri me shumë lehtësi, që të gjitha i paloi në një thes edhe atë ende kishte vend për të futë gjëra tjera, e kjo ishte mjeshtëria dhe eksperiencia ushtarake! Pas mobilizimit na dërguan në një vend tjetër, aty ku bëmë fotografimin për letërnjoftimet ushtarake e cila ishte një kartelë ushtarake e cila i përngjante asaj të patentë shoferit Amerikan. Po, disi si e kamuflazhuar, ku kishim të shënuara të gjitha të dhënat personale me të cilën u bë edhe kompletimi i plotë i dokumentacionit për t'iu bashkangjitur forcave ushtarake si dhe për udhëtim. Me këtë edhe kjo ditë përfundoi.

*E mërkurë 21 prill 1999*

Sot ishte dita e katërt e në Bazën Ushtarake të Fort Benning, edhe gjithëçka po shkonte sipas orarit ushtarak, zgjuarja rreth orës 6:00, para orës 7:00 ngrënia e mëngjesit, në orën 7:30 takimi me ekipet ushtarake për detyrat e ditës që kishim. U takuam në 7:30 me njërin nga grupet ushtarake dhe aty na u spjegua se sot do të shkonim në ushtrimin e përdorimit të maskës së gazit dhe për të qenë i gatshëm në rast rreziku të ndonjë sulmi me armë bio- kimike. Na dërguan që të gjithëve së bashku me ushtar të tjerë në një sallë pa asnjë dritare, aty ku në fillim na u mbajtë një ligjeratë me një film dokumentarë të sulmeve të armëve bio-kimike, dhe pastaj na u spjegua se çfarë përbërje ka maska e gazit, dhe pastaj se sa shpejtë duhet të vihet maska në përdorim dhe vurja sa më në mënyrë korrekte. Po, sepse aty ishin sekondat që të ndanin në mes jetës dhe vdekjes në rast të ndonjë sulmit bio-kimik! Ushtrimet zgjatën disa orë në errësirë të plotë, pa kurrëfarë drite, ku u bënë prova edhe me një lloj gasi që të zente frymën nëse nuk e kishe përdorë siç duhej maskën e gazit. Pas këtij ushtrimi edhe pse na kishin premtuar se do të na dërgonin në ushtrimet për

përdorimin e armëve me municion të ndryshëm, si dhe gjuajtjen me municion luftarak, fatkeqësisht planet kishin dështuar. Në të kthyer te baraka ku banonim, një oficer ushtarak na njoftoi se ne duhet të mblidhnim plaçkat tona dhe të bëheshim gati për udhëtimin tej oqeanit për në ditën e nesërme, sepse po kërkoheshin urgjentisht që të dërgohen përkthyesit shqiptarë për në Shqipëri, ku atje veçse kishin zbarkuar trupat amerikane dhe nuk kishin kurrëfarë përkthyesi. Edhe sot moti ishte shumë i mirë dhe me diell, me temperaturë rreth 70f (21C). Në orën 14:00 na urdhëruan të nxjerrim thesin tonë me çantën që kishim në skajet e rrugës, disa metra larg barakës ku qëndronim, të cilat do të paketoheshin dhe do të mbështjellëshin mirë në grumbujt e mëdhenj. Do të dërgoheshin para neve për transport në aeroportin e Atlantës, në aeroplanin me të cilin do të niseshim për në Gjermani. Në Atlanta prej ku e kishim edhe fluturimin. Aty u mblodhën shumë thasë dhe u bënë shumë pako dhe valixhe të cilat më vonë u ngarkuan në kamione edhe u nisën për në aeroportin e Atlantës. Derisa ishim në pritje të nisjes së kamionëve, kjo pamje më përkujtonte kohën kur isha fëmijë në shkollën fillore "Rilindja" të Llojanit edhe kur shihnim familjet të bashkëfshatarëve tanë duke u nisur për mos t'u kthyer më nga ikja e tyre për në Turqi, kur i tërë fshati dilnim për t'i përcjellë. Po sepse me neve aty kishin dalë edhe shumë ushtarë që kishin për të ndihmuar, e disa prej tyre edhe do të udhëtonin me ne për në bazat ushtarake Amerikane përtej oqeanit. Më vonë aty ku ishim mbledhë para barakave erdhën edhe dy autobusë të mëdhenj modern, jo ushtarak. Eprorët ushtarak erdhën aty dhe na i dorëzuan të gjithë dokumentacionin e udhëtimit që kishim bërë gjatë tërë kohës gjërë në ditën e sotme, edhe na dëshiruan rrugë të mbarë, dhe pas shërbimit edhe kthim të shëndetshëm në rrethet tona familjare këtu në SHBA. Që të gjithë që ishim grumbulluar aty hymë në autobusat që po na pritinin edhe u nisëm ne 6 përkthyesit shqiptarë që ishim edhe rreth 70 ushtarë e tjerë për në destinacionin drejt Aeroportit Ndërkombëtarë të Atlantës. Pas dy ore udhëtimit arritëm në aeroport, aty ku takuam edhe një grup të madhë ushtarësh që do të udhëtonin me ne për në Gjermani. Në aeroplan që do të fluturonim ishin mbi 200 ushtarë, të cilët nga Gjermania shumica ishin për në destinacionet e ndryshme të botës. Disa shkonin për në Bosne, ca të tjerë për në Kore e disa të tjerë për në Japoni! Nga aeroporti i Atlantës u nisëm me aeroplan charter, i cili ishte i mbushur me personel ushtarak. Në orën 21:00 të mbrëmjes u nisëm për në Frankfurt të Gjermanisë. Fluturimi ishte i qetë dhe mjaft komod, ku rreth orës 10:00 të mëngjesit arritëm në aeroportin e Frankfurtit, mirëpo aterimi ishte në pjesën e kundërt të aeroportit civil. Pra ishte pjesë e



veçantë e aeroportit e cila ishte dedikuar veçanërisht vetëm se për fluturime të personelit ushtarak.

*E enjte 22 prill 1999*

Edhe sot ishte një ditë e bukur me diell, por shumë më e freskët se sa ato ditë në Fort Benning të Xhorxhisë. Në aeroportin e Frankfurtit na pritë përfaqësuesi i TRW për të na dërgu me makinën e tyre për në bazën më të madhe të Forcave Ajrore Amerikane në Ramstein të Gjermanisë (US Air Force, Ramstein, Germany) për të vazhduar fluturimin me aeroplanët ushtarak drejt Shqipërisë.

Baza Amerikane e Ramstein'it ishte rreth 130 km larg Frankfurtit. Aeroporti ushtarak i Ramsteinit më përkujtonte shumë skena të filmave luftarakë, ku nga të gjitha anët e botës i sheh nga vinin dhe shkonin kontingjentet e ndryshme ushtarake. E gjithë pamja që dukej, vendi i pritjes mbrenda aeroportit i përngjante ishte një aeroporti të vogël, mirëpo kur dilje jashtë shihej se para nesh shtrihej fusha e gjatë dhe e pa fundë me shumë pista për aterimet e të gjitha llojeve të aeroplanëve ushtarak. Para neve gjithashtu shiheshin me qindëra e qindëra aeroplanë transportues ushtarak, disa duke u zbratur e të tjerët duke u mbushur me ngarkesat e tyre të ndryshme. Për një kohë qëndruam mbrenda aeroportit, e më vonë dikur në orën 1:00 pas mesnate na urdhëruan që të vishnim uniformat tona ushtarake, dhe pastaj të rreshtoheshim me ushtarët tjerë në dy taborre. Pastaj na urdhëruan të hecim nën komandën ushtarake drejt një e aeroplani të madhë transportues i cili ishte bukur largë në distance. Ishte i hapur dhe para me turirin e çuar lartë në qiell, por edhe prej mbrapa dukej sikur kur hynë në tunel ku futeshin lirisht tanke dhe automjete ushtarake! Bëmë nja 100 metra në këmbë, ku pastaj na futën në disa autobus ushtarak të cilët po na prisnin me dyer hapur me të cilët na dërguan edhe disa qinda metrash para një aeroplani të madhë 4 motorësh C 17 kargo transportues ushtarak, i cili ishte më tepër transportues malli se sa për udhëtarë. Para se me hy ne, aty hyri një kamionister mbushur me mall ushtarak, e pas tij ishin të renditur edhe 4 Humvee

ushtarakë (automjete ushtarake), si dhe paketimet e mëdha malli aty ku ishin edhe thasët gjësendet tona. Pas të gjitha atyre ngarkesave na urdhëruan që edhe ne të futemi mbrenda. Aty nuk kishte karrika por anash ishin ulëse me kollane plastike, diçka e pa zakonit për neve, çka nuk kisha parë ndonjëherë. Mbrenda fluturakes na ndanë në dy rreshta, 17 persona në një anë dhe 17 pjesëtarë në anën tjetër. Para nisjes ushtarët e aviacionit po bënë kalkulimet e tyre të ndryshme për baraz peshën, si dhe shtrëngimin e mallit për dysheme me kollanet e ndryshme! Para fluturimit njëri nga pilotët ushtarak të aeroplanit erdhi na përshëndeti edhe na u drejtu neve përkthyesve shqiptarë duke na u afruar na tha: "Poqëse jeni të interesuar të shihnim brendësinë e kabinës së pilotëve ejani pas meje e t'ju tregojë edhe t'ju njoftoj sadopak në lidhje me këtë Aeroplan C 17 se si funksionon! Neve, 2-3 veta shkuam pas pilotit i cili na spjegoi shumë gjëra, dhe pastaj na mori mbrenda kabinës së pilotëve aty ku kishin qenë të ulur dy ushtarak me të cilët na njoftoi. Njëri prej tyre ishte pilot, kurse tjetri inxhinier i aviacionit të cilët ishin ulur para një tabloje me lloj-lloj dritash si dhe me pulla të pa numërta në mbrendësinë e kabinës prej ku po kontrollohej e gjithë fluturakja C17. Na tregoi se këtë aeroplan e fluturojnë vetëmse dy pilotë me dy ndihmës pilot, kurse modelet e vjetëra të të njejtimit aeroplanë ishin dashtë 4 pilotë për ta fluturuar. Piloti ushtarak na spjegoi se ky aeroplan ishte prodhimi më i ri që e posedonin Forcat Ajrore të Amerikës (U.S. Air Force), dhe na thanë se ky aeroplan ishte krejtësisht i automatizuar dhe se mundë të fluturojë krejtësisht në vete, pra pa ndihmën tone. Donë të thotë me auto-pilotë, dhe lirisht mundë të ngritet e të fluturojë po edhe mundë të aterojë vetë. Krejtësisht në mënyrë të kompjuterizuar! Për ne e gjithë pamja e mbrendëshme e kabinës së aeroplanit ishte diçka që e kishim parë vetëm nga filmat fantastik, për të cilin me plot entuziazëm po na spjegonte piloti ushtarak i cili ishte një pilot ushtarak i moshës rreth 30 vjeçare i këtij aeroplani C17! Pas nisjes së aeroplanit për derisa po lëvizim përgjatë pistës, pak



para ngritjes në ajër u duke se e gjithë toka po dridhej nga fuqia e madhe e motorëve shumë të fuqishëm që kishte kjo fluturake C 17, mirëpo pas disa minutash, pas ngritjes në ajër gjithçka u qetësua. Fluturimi ishte mjaftë komod dhe më dukej sikurëse po lundronim në valët e qeta të detit me luhatje shumë të lehta të kohë pas kohëshme. Më vonë na u shpërnda darka MRE, ushqim i pakeluar ushtarak, pas darkës filluam bisedën me eproret ushtarake amerikanë të cilët edhe ata po shkonin në të njëjtën bazë ushtarake në aeroportin e Rinasit në Shqipëri. Atje ku po bëheshin përgaditjet e fundit për ndërhyrjen ushtarake drejt Kosovës kundër kriminelëve të Serbisë, si edhe me njësitë tjera ushtarake siç ishin ato të këmbësorisë, edhe artilerisë që mezi po prisja të shihja.

Ne aeroportin e Rinasit të Shqipërisë arritëm në orën 3:30 pas mesnate. Në të dalur nga aeroplani pamë se ishte moti me shi edhe mjaftë ftohtë, gjithandej për rreth nesh ishte errësirë dhe baltë.

Kjo ditë më solli në kohën para 9 vitesh nga vizita ime në Shqipëri, dhe tani ishte hera e dytë e jetës time që po shkëlqim në tokën e nënës Shqipëri.

Së pari herë erdhëm këtu në Shqipëri para nëntë vjetësh, në kohën e Ramiz Alisë. Ishte fillimi i Korrikut 1990, ishte koha kur posa erdhëm në vizitë në Jugosllavi prej SHBA'së, unë dhe bashkëshortja Shahadija. Ndëguam nga një shok prej Presheve se po organizohej vizita një javore për një grup turistësh për në Shqipëri. Menjëherë i kërkua atje që të na i rezervojë dy vende edhe për ne, dhe pas një jave herët në mëngjes u nisëm nga qyteti i Shkupit me autobus të Maqedonisë, ku në kufi të Qafëthanës arritëm vonë pas dite. E tërë grupa kaluam kufirin në këmbë, kurse në anën tjetër të kufirit po na priste autobusi i "Albturistit" të Shqipërisë me ciceronët e tyre. Ne të gjithë përbënim një grup prej 12 vetash, dhe shumica prej nesh ishim të diasporës shqiptare, por ishte edhe një grua nga Ferizaji që po vizitonte për herë të parë vëllauin e sajë në Shqipëri dhe disa të rinjëve tjerë nga Maqedonia. Deri sa ne ishim në Sarandë ishte dita kur në Prishtinë u bë shpallja e Kosovës Republikë më 2 korrik 1990! Ishte 3 korriku 1990 dita jonë e fundit në Tiranë para se të largoheshim nga Shqipëria, dhe gjatë largimit nga Shqipëria në drejtim të Maqedonisë ndëguam për fillimin e Eksodit shqiptarë, hyrjen dhe kërkimin e azilit për strehim nëpër ambasadat e huaja në Tiranë...

\*\*\*

Nga eroplani erdhën edhe na morën me kamionin ushtarak Amerikan dhe na dërguan në një çadër e cila ishte diku afër pistës së aeroportit, e cila ishte pa dyer, pa dritare, ku edhe shiu po pikonte mbrenda gati se gjithëkund! Aty në këtë çadër në fillim bëmë regjistrimin për eprorët ushtarak, si dhe na thanë se së shpejti do të vijë edhe përfaqësuesi i grupit tuaj të përkthyesve nga TRW, një farë Vlado. Një boshnjak i cili kishte qenë përgjegjës për ne, dhe i cili

nuk erdhi asnjëherë! Dikur rreth orës 10:00 para dite, erdhi një kamion ushtarak i cili ndaloj para çadrës tonë dhe na urdhëroi që t'i marrim secili plaçkat e tona edhe me hypë në atë kamionin ushtarak i cili u nis menjëherë edhe na dërgoi në qendrën ku po bëhej shpërndarja e përkthyesve për njësitë përkatese ushtarake. Po atje ku ishte nevoja më e madhe për përkthyes. Gjatë pritjes për të na e caktuar njësinë ushtarake dhe duke i parë kushtet e vështira jetësore në këtë vend, njëri nga kolegët tanë përkthyes shqiptarë, i cili kishte ardhë nga Nju Jorku kërkoi kthimin e menjëhershëm për në shtëpi. Duke na thënë se ky vend nuk qenka për të! Këtijë përkthyesi të rijë i cili ishte në të 20'tat, iu mundësua kthimi po në të njëjtën ditë me një aeroplan tjetër ushtarak për në Gjermani, ku pastaj ai të vazhdojë udhëtimin e tij për në shtëpinë e vetë në Amerikë. Mua më morën dhe më dërguan në batalionin e kompanive raketore Bravo, Charlie dhe Alfa, ku për kapiten ishte Kapiteni Lerner, i cili ishte një oficer ushtarak i qetë dhe kishte respekt të veçantë ndaj meje. Ishte i moshës 35 vjeçare dhe me një eksperiencë të madhe ushtarake. Respekt të veçantë gëzoja edhe nga të gjithë kompanitë me të cilët isha caktuar që të punoja.

### OPERACIONI I FORCAVE ALEATE (OPERATION ALLIED FORCE)

Në "Operacionin e Forcave Aleate" (Operation Allied Force) personazhet kryesore të arenës së bombardimeve 78 ditëshe të NATO's mbi forcat paramilitare ushtarake serbe, akcioni botës peren- dimore udhëhiqej në tërësi nga Komanda Supreme e Aleancës së NATO's në Bruksel: në krye me Gjeneralin Wesley Clark, i njohur për sukseset e tij nga Lufta në Vietnam dhe tani edhe në Luftën e Kosovës, Lt. Gjenerali Michael E. Short komandues i përgjithshëm i forcave ajrore në Luftën e Kosovës, Gjenerali Henry Shelton kryeshefi i shtabit të përgjithshëm, Gjeneral Henry Shelton, ishte i njohur nga Lufta në Vietnam dhe tani për operacionet në Kosovë, Gjenerali John Walter Hendrix i njohur nga lufta e Vietnamit, në luftën e Gjiut në Lindjen e Mesme dhe tani si dirigjues i bombardimeve me grupin tonë bashkëpunues prej Kukësit në Shqipëri për Luftën e Kosovës si fitues i shumë çmimeve, medaleve dhe meritave ushtarake, Gjenerali Kudusi Lama Komandant i Divizionit të Këmbësorisë në Kukës dhe Shtabit të Përgjithshëm ndërmjetësues i ynë me NATO'n për bashkëpunim me UÇK'në, dhe Gjenerali i UÇK'së Agim Çeku i njohur dhe dekoruar nga luftërat në Kroaci, Bosne dhe Hercegovinë dhe tani në Kosovë. Operacioni i Forcave Aleate filloi më 24 mars 1999, duke u shfrytëzuar mëse 250 aeroplanë amerikanë, duke përfshirë 120 aeroplanë luftarakë, 7 bombardues të mëdhenjë B-52, 6 bombardues B-2, 10 aeroplanë zbulues, 10 aeroplanë luftimi dhe kërkim shpëtimi, 3 aeroplanë komandës të platformës së kontrollit edhe 40



aeroplanë tankera për rimbushjen në ajër të aeroplanëve luftarak. Në këtë akcion morën pjesë edhe 13 shtetet tjera pjesëtare të aleancës së NATO's që kontribuan me forcat e tyre të aviacionit ajror.

Gjatë natës së parë SHBA'ja dhe NATO'ja bënë mëse 400 misione fluturimesh, në përbërje të 120 misioneve të sulmeve kundër 40 caqeve.

Në ditën e dytë të operacionit, Forcat Ajrore Amerikane me aeroplanët e tyre F-15 qëlluan dhe rrëzuan 2 aeroplanë luftarak serb MiG-29, si dhe qëlluan caqe të tjera. -Qëllimi i Operacionit të Forcave Aleate ishte i kundërpërgjigje të represaljes serbe mbi popullatën e pa armatosur civile në Kosovë. Me këtë operacion shpresohet dhe pritej ndërprerja e menjëherëshme e të gjitha sulmeve serbe mbi popullatën e pa mbrojtur civile shqiptare, si dhe tërheqja e të gjitha forcave serbe, si ajo e personelit ushtarak, policor si dhe paramilitare nga Kosova.

Plani i Perëndimit e në veçanti ai amerikan ishte që në Kosovë të sillen forcat paqëruajtëse, dhe në veçanti forcat e NATO's, si dhe të sigurohej kthimi i refugjatëve shqiptarë të dëbuar nga shtëpitë e tyre, si dhe t'i ofrohej ndihma reugjatëve nëpërmjet organizatave humanitare. Gjithashtu ishte edhe plani për formimin e forcave politike për vetëqeverisje të vendit mbrenda Kosovës.

*E shtunë 24 prill 1999*

-Oficeri i cili erdhi dhe më mori nga çadra e linguistëve për në njësinë e tij, ishte Kapiteni Lerner i Armatës Amerikane që po udhëhiqte Njësinë e Artilerisë me "MLRS" Lancuesit Raketorë (Multiple Launch Rocket System). Kjo njësi me të cilën isha edhe unë tani po bënim përgaditjet finale në rastë të futjes së këmbësorisë mbrenda arenës së luftës në Kosovë kundër forcave të armikut gjakatarë Serb. Për momentin këtu në Rinas kishim 27 Lancues Raketash MLRS të cilët ishin të gatshme për të sulmuar objektivat serbe, me të cilat mundeshite të sulmohej në një distancë prej Shqipërisë ku ishim ne, deri në qytetin e Beogradit. Këto raketa kishin fuqinë që në objektivat e caktuara të shkatërronin gjithçka që gjindej në atë perimetër, në përmasa të një stadiumi të futbollit. Gjithashtu përballë nesh ku ishim vendosur kishim edhe njësinë e

helikopterëve ushtarak, e që ishin ndër më të avancuarit në botën e kësajë teknologjie luftarake, aty kishim 24 helikopterë Apache AH-64, të cilët kishin arritur në këtë vend që nga 04 Prilli 1999, dhe ishin të gatshëm në çfarëdo momenti për të sulmuar forcat e armikut.

Vend qëndrimi im tani ishte në një çadër ushtarake, në mes të livadheve ku po na rrethon balta e cila ishte shkaktuar nga levizjet e ushtarëve amerikan për rreth në Aeroportin e Rinasit, i cili gjindet rreth 20 km. nga kryeqendra e Shqipërisë - Tirana, (Kryeqyteti i Shqipërisë), buzë pistës së aterimit të aeroplanëve, e që ç'do aeroplan që ngritej apo lëshohej në Aeroportin e Rinasit, gati se na i çonte të gjitha çadrat në ajër, dhe na dridhte me gjithëçka që kishim! Në anën tjetër kisha pamjen magjepëse të kurorës së maleve të Krujës, atje ku heroi ynë legjendar Gjergj Kastrioti-Skenderbeu ku prej andej me shumë sukses e mbrojti Arbërinë nga Perandoria e Osmanlinjve për 25 vjet rresht.

Këtë vend ku po qëndronim ne tani edhe ushtarët Amerikan veçëse e kishin emëruar si "Kampi i Baltës" (Mud Camp). Koha që nga ardhja jonë në këtë vend ishte pothuajse çdo ditë me shi dhe mbante mjaftë ftohët, e që po përngjante më shumë si stinë vjeshte edhe pse ne ishim në pranverë, ku edhe balta na e bënte edhe më të mërziqshëm qëndrimin tonë në këtë vend. Kishte aq shumë baltë sa që për herë të parë në jetën time kam parë që ushtari të mbetë në të, dhe për të dalë nga balta shokët e tij i hodhën litarë duke ngrehur zvarrë e nxorrën prej balte! Koha ishte aq e keqe sa që kishte detyruar edhe aviacionin e NATO's që të ndërpresë bombardimet mbi forcat e armikut serb në Kosovë dhe mbrenda Jugosllavisë. Në mbrendësi të çadrës kishim nivelin e ujit rreth 5cm., dhe gjithkund ku e lëshohe këmbën ishe në ujë. Sa për t'ia përmirësu kushtet vetes neve morëm zallin me kova dhe sollëm aty afër dhe shtruam mbrenda çadrës disa rrugica zalli, sa për të mundë me shku deri te shtretërit tanë aty ku bënim gjumin në krevatin e metalte në thesin e gjumit. Për fillim problem kryesor ishte edhe pastrimi i trupit (larja) sepse nuk kishim ujë të nxehtë dhe të rrjedhshëm. Për pastrim përdornim bidona plastike me 1.5 litër ujë të cilin e nxehnim pak sa për të larë flokët! Çadrat ishin rreth 100

metra në largësi nga pista e aeroportit, dhe zhurma e aeroplanëve ishte e pa durueshme, por ndoshta edhe shumë e rrezikshme në rastë të ndonjë aksidenti të aeroplanëve.

Trafiku ajror gjatë kësajë kohe në Rinas ishte mjaftë i ngarkuar, dhe ky aeroport tani po shfrytëzohej kryesisht e vetëm se për aeroplanët ushtarakë të NATO's, e në veçanti të Forcave Ajrore Amerikane si edhe të disa prej aeroplanëve kargo që po sjellnin ndihma për refugjatët nga Kosova, të cilët ishin të shpërndarë gjithëkund nëpër Shqipëri.

Ndihmat vinin nga vendet e ndryshme të botës. Në çadrën ku isha vendosë unë, shumica ishin epror të gradave më të larta ushtarake, si dhe aty afër meje ishte edhe një gazetar që kishte raportu nga shumë luftëra, nëpër shtetet e ndryshme nga të gjitha kontinentet e rruzullit tokësorë, e që quhej Doug Mellgreen, i cili raportonte nga Shqipëria për "Associated Press". Ai raportonte rregullisht për përgaditjet dhe gadishmërinë e forcave amerikane prej këndeje kampit ushtarak të Rinasit nga Shqipëria. Meqenëse kishte shtratit e tij shumë afër meje në këtë çadër, gjatë kohës së lirë shkëmbeu informata të ndryshme me të, unë nga ato ushtarakë e ai nga lajmet më të reja nga rajoni, sepse kisha humbë lidhjet me të gjithë botën jashta kampit ushtarak në Rinas që kur kisha ardhë këtu në Shqipëri! Gjatë ditëve të para nuk kisha aq shumë punë dhe nuk isha i nxanun, përveçëse nganjëherë që shkonim me eprorin tim ushtarak Kapitenin Lerner në një familje shqiptare e cila po jetonte shumë afër çadrave ushtarake Amerikane. Këtij shtëpiakut shqiptar i ishte dhënë urdhëri që të largohej nga kjo pronë, mirëpo ai refuzonte të largohej prej aty për derisa nuk i paguhet ajo shtëpi e cila i përngjante më tepër një shtalle të vogël. Komanda ushtarake vendosën që t'ia paguajnë mirëpor problemi po qëndronte se ai nuk kishte kurrëfarë dokumentacioni të cilin e bënte pronar të asajë prone dhe atij objekti banues. Arsyeja pse kërkonin largimin e kësajë familje ishte më tepër për shkak të sigurisë ushtarake, sepse ata ishin krejtësisht afër çadrave ku ishim të vendosur edhe ne pjesëtarët e Armatës Amerikane.

*Vjion*

# Cilat janë “viruset zombi”, ende të gjalla pas 50 mijë vjetësh

Temperaturat gjithnjë e më të larta në planetin tonë, po prekin edhe të ashtuquajturin “ngricë të përhershme”, shtresën e tokës së ngrirë ose Permafrost, e cila përmban viruse që “fleenë” prej mijëra vjetësh. Por çfarë mund të ndodhë me shkriren e Permafrostit?

Kimberli Miner, shkencëtare e klimës në Laboratorin e Institutit të Teknologjisë të NASA-s në Kaliforni, thotë se situata është shqetësuese. “Ka disa elementë shqetësues në lidhje me ngricat e përhershme. Ndaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që të ruhet sa më e ngrirë pjesa më e madhe e Permafrostit” - thotë ajo. Permafrost mbulon 1/5 e Hemisferës Veriore.

## “Viruset zombi” të gjallë pas 50 mijë vjetësh

Shkrija e pjesshme e kësaj shtrese bart jo pak rreziqe, siç theksohet edhe nga studiuesi tjetër Zhan-Mishel Klaveri, profesor i mjekësisë dhe gjenomës në Universitetin e Marsejës, Francë. Shkencëtari ekzaminoi mostrat e Permafrostit të marra në Siberi për të kërkuar ato që ai i quan “viruse zombi”. Shkencëtari studion lloje të veçanta të viruseve të zbuluara që në vitin 2003. Për shkak të madhësisë së tyre, ato janë të dukshme përmes një mikroskopi normal. Në vitin 2014, profesori arriti të rikthejë në jetë një virus të izoluar nga ngrica e



përhershme. Nëpërmjet përdorimit të kulturave qelizore, virusi ka rifituar karakteristikat e tij infektive pas 30.000 vjetësh. Për arsye sigurie, eksperimenti përfshiu një virus të aftë të prekte vetëm organizmat njëqelizore, dhe jo kafshët apo njerëzit. Në vitin 2015, ekipi e përsëriti studimin mbi një virus të aftë të prekte amebat. Ndërsa në studimin e fundit, të botuar më

18 shkurt në revistën “Virus”, Klaveri izoloi disa shtame virusi nga mostrat e shumta të Permafrostit të marra nga 7 zona të ndryshme në të gjithë Siberinë, dhe tregoi se çdo lloj i tyre mund të infektojë qelizat e kultivuara të amebës.

Virusi më i vjetër daton 48.500 vjet më parë. Më i ri 27.000 mijë vite më parë. “Ne i konsiderojmë këto viruse që infektojnë amebën

si zëvendësues të gjithë viruseve të tjerë të mundshëm që mund të gjenden në Permafrost. Ne shohim gjurmë të shumë viruseve të tjera. Ne e dimë që ato janë atje. Nuk e dimë me siguri nëse janë ende gjallë. Por nëse viruset e amebës janë ende gjallë, nuk ka arsye pse viruset e tjerë të mos jenë ende të gjallë dhe të aftë të infektojnë bujtësit e tyre” - deklaroi Klaveri për CNN.

## Viruse të rrezikshme për njerëzit

Tashmë në Permafrost janë identifikuar gjurmët e viruseve dhe baktereve që mund të infektojnë njerëzit. Në fragmentin e një mushkërie të marrë nga trupi i një gruaje, të zhvarrosur në vitin 1997 nga ngrica e përhershme në një fshat në Gadishullin Sjuard në Alaskë, u identifikua materiali gjenomik i llojit të gripit, që ka qenë përgjegjës për pandeminë e vitit 1918.

Në vitin 2012, shkencëtarët konfirmuan se mbetjet 300-vjeçare të mumifikuara të një gruaje të varrosur në Siberi, përmbanin gjurmë të virusit që shkakton linë. A ka rreziqe reale nga shkrija e Permafrostit? Shkencëtarët nuk e dinë se edhe për sa kohë çdo virus i “ngrirë” mund të mbetet efektiv pasi të jetë ekspozuar ndaj kushteve të sotme.

Po ashtu nuk mund të përcaktohet me siguri as se sa gjasa ka që virusi të ndeshet me një bujtës të përshtatshëm. Jo të gjithë viruset janë patogjenë që mund të shkaktojnë sëmundje. Disa janë beninj apo edhe të dobishëm për strehuesit e tyre. Megjithatë, Klaveri thotë se “rreziku do të rritet në kontekstin e ngrohjes globale, sepse shkrija e ngricave të përhershme do të vazhdojë të përshpejtohet, dhe më shumë njerëz do të popullojnë Arktikun si rezultat i nismave industriale”. / today.it - bota.al

# Bukuria e rrezeve Gama në Univers


## Ka kaluar shumë kohë që kur ne zbuluam rrezet gama.

Fundi i viteve 1800 dhe fillimi i viteve 1900 ishin një kohë e përparimeve të mëdha shkencore. Shkencëtarët sapo po merrnin një kontroll mbi llojet e ndryshme të rrezatimit. Radiumi u shfaq dukshëm në eksperimente, duke përfshirë një nga shkencëtari francez Paul Ulrich Villard në 1900.

Radiumi shpërbëhet lehtësisht dhe shkencëtarët kishin identifikuar tashmë rrezatimin alfa dhe beta që vinte nga mostrat e radiumit. Por Villard ishte në gjendje të identifikonte një lloj të tretë të rrezatimit depërtues qaq të fuqishëm që edhe një shtresë plumbi nuk mund ta ndalonte atë: rrezet gama.

Tani ne kemi një detektor të rrezeve gama në hapësirë, dhe po na tregojnë se si Universi shkëlqen me këtë energji të fuqishme.

Rrezet gama janë forma më energjike e dritës në Univers, dhe siç tregojnë një animacion i ri, qielli praktikisht shkëlqen nga burimet



e rrezeve gama. Animacioni përmban vëzhgime të një viti nga Teleskopi i Zonës së Madhe (LAT) në teleskopin hapësinor me rreze gama Fermi të NASA-s. Çdo rreth i verdhë është një burim i rrezeve gama, dhe zgjerimi dhe tkurrja tregojnë se si burimi shkëlqen dhe zbehet. Rrethi i verdhë është rruga e Diellit që ndjek rrugën e

tij në dukje sinusoidale në lidhje me Tokën.


Animacioni përfaqëson një vit të tërë vëzhgimesh. Çdo kornizë në animacion përfaqëson tre ditë. Brezi i kuqërremtë-portokalli që kalon në mes të animacionit është rrafshi qendror i Rrugës së Qumështit, i cili është një prodhues i qëndrueshëm i

rrezeve gama.

## Ajo që imazhi na tregon vërtet janë vrimat e zeza.

Këto drita pulsuese përfaqësojnë vrimat të zeza supermasive, ose shumicën e tyre. 90% e këtyre burimeve janë ato që quhen

blazars. Blazarët janë bërthama aktive galaktike, të cilat në thelb janë vrima të zeza. Blazaret janë objektet më të shndritshme dhe energjike në Univers. Ata lëshojnë fotone të rrezeve gama dhe janë shumë të ndryshueshme në shkëlqim, gjë që shpjegon zgjerimin dhe tkurrjen e burimeve të rrethit në imazh. / bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Invert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Trepça fiton derbin dramatik me Vushtrinë

**MITROVICË, 26 MARS** - Portieri Mohammed Chahre Hachemi ndali një gjuajtje në sekondat e fundit për të ndihmuar fitoren e Trepçës ndaj Vushtrisë. Të dielën mbrëma në "Minatori", Trepça fitoi me një gol epërsi, 31:30. Ndashja i ka takuar xhiros

së 23-të të Superligës A të Kosovës në hendboll. Ndashja ishte e hapur dhe dramatike deri në fund. Në fakt në pjesën e parë vendasit mbajtën vazhdimisht epërsi prej disa golash. Por në të dytën vushtriasit u kthyen dhe krijuan epërsi deri në tri gola,

25:22. Më pas u luajt ndeshje e fortë dhe interesante deri në fund, kurse festa u takoi mitrovicasve. Pos portierit Hachemi te Trepça u dalluan edhe Deniz Terziqi me dhjetë gola dhe Yassine Henahen me gjashtë. Lulzim Shabani shënoi

pesë gola, duke përfshirë dy të fundit. Te Vushtria, Bozhidar Nikoçeviq i shënoi 13 gola, ndërsa gjashtë i kishte Nemanja Drakuloviq. Trepça është forcuar në pozitën e dytë. I ka 28 pikë. Vushtria ka rënë në vendin e katërt me 22 pikë.



## Trepça triumfon ndaj kampionit, Peja vazhdon me fitore

**SUHAREKË, 26 MARS** - Trepça ka shënuar fitore në Suharekë ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 85:91 (27:19, 28:26, 14:23, 16:23), në xhiron e 27-të të Prince Caffë Superligës. Mitrovicasit bënë përmbysjen në pjesën e dytë, duke triumfuar në derbin e kësaj xhiro. Pas një fillimi të barabartë, vendasit kishin deri në nëntë e dhjetë pikë, ndërsa çerekun e parë e fituan 27:19. Therandasit vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, ku ngritën epërsinë, që më e larta shkoi deri në 15 pikë, 44:29, ndërsa pjesa e parë përfundoi 55:45. Mitrovicasit u rikthyen fuqishëm në periudhën e tretë, ku shkrijnë epërsinë e vendasve dhe e kthyen atë në favor të tyre, 64:66, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 69:68. Por, "Xehetarët" nuk u ndalën dhe vazhduan me lojë të mirë,

ku kishin deri në dhjetë pikë epërsi 72:82, por drama zgjati deri në fund, pasi kampionët nuk u dorëzuan dhe rikthyen epërsinë në 84:82 me një seri prej 12:0, sidoqoftë, mysafirët ishin më të mirë në çastet e fundit dhe triumfuan 85:91. Më i miri te kampionët ishte Henrik Sirko me 23 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime, ndërsa te nënkampionët më të mirët ishin Drilon Hajrizi me 15 pikë e dhjetë kërcime dhe Erjon Kastrati me 18 pikë. Golden Eagle Ylli ka 19 fitore e tetë humbje, kurse Trepça 16 fitore e 11 humbje. Ndërsa Peja ka shënuar fitoren e shtatë radhazi në elitë, duke mundur kësaj radhe, Bashkimin me rezultat 95:79 (33:14, 14:25, 25:25, 23:15), sfidë kjo e zhvilluar në kuadër të Prince Caffë Superligës së Kosovës në



basketboll. Pejanët e nisën furishëm çerekun e parë duke ngritur epërsinë dhe e fituan bindshëm këtë pjesë 33:14. Por, prizrenasit u rikthyen në periudhën e dytë për të ngushtuar shifrat në 47:39, sa përfundoi pjesa e parë e kësaj përballje. "Portokallezinjtë"

vazhduan me lojë të mirë në periodën e tretë, ku ngushtuan rezultatit edhe më shumë, në 50:47, e më pas zhvillohet lojë e baraspeshuar, ndërsa në fund pejanët shkëputen sërish për 72:64. Në dhjetë minutat e fundit prizrenasit tentuan rikthimin, por Peja nuk lejoi një

gjë të tillë dhe triumfoi 95:79. Te "verdhezinjtë" u dallua Jalen Tate me 23 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime, ndërsa te "Portokallezinjtë" u dalluan Daniel Lekndreaj me 15 pikë e 12 kërcime dhe Fisnik Rugova me 22 pikë e 13 kërcime. Peja ka 20 fitore e shtatë humbje, kurse Bashkimi 11 fitore e 15 humbje. Sigal Prishtina ka shënuar fitore të pritur, duke mundur Rahovecin me rezultat 97:75 (27:19, 19:19, 24:22, 27:15). Te vendasit u dalluan Nate Grimes me 18 pikë e dhjetë kërcime dhe Both Gach me 20 pikë, tetë kërcime dhe katër asistime, kurse te mysafirët u dalluan Igor Chumakov me 22 pikë e nëntë kërcime dhe Jack Pagenkopf me 19 pikë, katër kërcime e tre asistime. Sigal Prishtina tani numëron 20 fitore e gjashtë humbje, kurse Rahoveci katër fitore e 23 humbje.

## Shqipëria sonte përballlet me Poloninë

**TIRANË, 26 MARS** - Kombëtarja e Shqipërisë ka mbyllur të dielën përgatitjet për ndeshjen e parë të kualifikueseve të Evropianit 2024 ndaj Polonisë, që luhet të hënën në mbrëmje në Varshavë. Delegacioni kuqezi ka mbërritur në mesditë në Poloni. Pas një pushimi skuadra i është drejtuar stadiumit të ndeshjes PGE Narodowy dhe fillimisht trajneri Sylvio Mendes Campos Junior ka dalë në konferencën zyrtare për shtyp së bashku



me sulmuesin Sokol Cikallesi dhe më pas ekipi ka zbritur në

fushë. "Po, jemi gati, pas dy muajsh e gjysmë punë, kam

punuar për të monitoruar futbollistët shqiptarë dhe për të zgjedhur 23, të cilët janë këtu. Jam shumë i kënaqur me të gjithë punën që kemi bërë gjatë 6 ditëve, me atmosferën që kemi krijuar të gjithë së bashku", ka thënë trajneri Sylvinho. "Ndashjet luhen 90 minuta, megjithatë unë dua që skuadra të hyjë në fushë menjëherë agresive dhe gati për të luftuar për çdo top. Sigurisht 10-15 minutat e para janë të komplikuar, duke

ditur që luajmë në Poloni, por duhet të luajmë të përqendruar gjatë gjithë 90-minutëshit. Konkluzionet do t'i nxjerrim më fund të ndeshjes, por ne jemi gati të garojmë deri në fund për objektivin tonë", ka deklaruar trajneri i kuqezinjve. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm tifozësh shqiptarë do të jenë të pranishëm në stadiumin e Varshavës për të mbështetur kuqezinjët në këtë rrugëtim të ri.

## Kosova pësoi humbje nga Franca

**PRISHTINË, 26 MARS** - Edhe në ndeshjen e dytë në kuadër të ndeshjeve parakualifikuese të raundit të dytë të Ligës A Grupi 5 për "Euro 2023", Kosova U17 e vajzave pësoi humbje. Kësaj radhe "Dardanet" e reja nuk arritën të përballojnë Kombëtaren e Francës, e cila

kishte nivel dukshëm më të mirë, duke fituar 5:0. Pjesa e parë kaloi në shenjë të futbollisteve franceze, të cilat ishin më cilësore dhe më të përgatitura nga pikëpamja fizike sa që lenin përshtypje se janë më të rritura se vajzat tona. Ato shënuan tri herë në këtë

pjesë. Së pari Rambaud shënoi në minutën e 18-të për 1:0, ndërsa në minutën e 25-të Ben Khalied shënoi për 2:0 dhe në minutën e 36-të Joseph shënoi për 3:0. Edhe pseja e dytë nuk pati dallime sa i përket lojës, pasi mbizotërimi i vajzave franceze vazhdoi. Në këtë pjesë

u shënuan edhe dy gola, ku në minutën e 74-t shënoi Traore për 4:0, ndërsa pesë minuta më vonë në atë të 79-të Efi Efi vulosi rezultatit e ndeshjes në 5:0. "Dardanet" ndeshjen e radhës dhe të fundit do ta zhvillojnë më 29 mars kundër Italisë.





Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1, nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.1037 të datës 27.03.2023, Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

### KONKURS PUBLIK

**Pozita e punës: Receptionist**

**Numri i pozitave: 1 (një);**

**Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi**

**Niveli i Pagës: XXII**

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

Detyrat dhe Përgjegjësitë Sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Të ketë të kryer shkollën e Mesme (dëshmi diploma),
- Te ketë se paku 1 vit përvojë pune,
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë në grup;
- Njohja e punës me kompjuter Programet Word dhe Excel.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

1. Aplikacioni për punësim mund të merret në zyrat e Trafikut Urban apo përmes web-faqes së TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
2. Diploma e shkollimit;
3. Dëshmi mbi përvojën e punës;
4. Kopja e letërnjoftimit;
5. Dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj.

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com).

Konkursi është i hapur nga data **27.03.2023** dhe përfundon më datë **10.04.2023** në ora **24.00**.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Prishtinë, më 27.03.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



U prilog članu 8. Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1, član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima, i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.1037 od 27.03.2023.godine, Zamenik Izvršnog Direktora NPK „Trafiku Urban“ SHA, Priština, objavljuje:

### UNUTRAŠNJI KONKURS

**Radno mesto: Receptionist**

**Broj pozicija: 1 (jedan);**

**Trajanje: 1 godina sa mogućnošću produženja**

**Nivo plate: XXII**

**Dužnosti i odgovornosti:**

Dužnosti i odgovornosti prema Pravilniku o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta.

**Kvalifikacije i veštine:**

- Da ima završenu srednju školu (dokaz diplome),
- da imaju najmanje 1 godinu radnog iskustva,
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Poznavanje rada na računaru, Vord i Excel programa.

**Potrebna dokumentacija:**

1. Zahtjev za zapošljavanje se može dobiti u kancelarijama za gradski saobraćaj ili preko internet stranice TU <http://vww.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacioni-shk.html>;
2. Diploma o stečenom obrazovanju;
3. Dokaz o radnom iskustvu;
4. Kopija lične karte;
5. Dokaz iz suda koji nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci.

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

**Opšte informacije:**

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

**Način primene:**

Prijava se može izvršiti samo putem mejla: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com).

Konkurs je otvoren od 27.03.2023 i završava se 10.04.2023 u ponoć.

**Napomena:** Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

Datum:

27.03.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besartë Faik Thaqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Albana Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mirlinda Nuhaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 dhe diplomën certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Enis Buqinca nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Edona Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf "Selman Riza" nga kl. I-VIII në Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues